



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor
“Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze”
Kolegji Universitar “Logos”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Dr. Zana Strazimiri

2. Dr. Genti Kruja

Tetor 2021

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bsc në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze” të ofruar
nga Kolegji Universitar “LOGOS”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Logos”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 192 datë 24.04.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	I parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE/ 16 PAK v.a. 2020-2021 7 PAE/ 15 PAK v.a. 2019-2020 5 PAE/ 8 PAK v.a. 2018-2019
18	Numri i studentëve:	17 Studentë v.a. 2018-2019 6 Studentë v.a. 2019-2020 6 Studentë v.a. 2020-2021
19	Komente / të tjera:	



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze” ofrohet nga Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, pjesë e strukturës së Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor të KU “Logos”.


Si një nga tre Fakultetet e Kolegjit Universitar LOGOS (licensuar me VKM Nr. 1055, dt. 29.07.1999, i njohur me Statusin e Kolegjit Universitar me Urdhrin Nr. 93, dt. 06.03.2017 e Ministrit të Arsimit dhe Sportit), Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor u licensua me Urdhrin Nr. 408, dt. 13.07.2018 e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke pasur në përbërjen e tij tre departamente: 1) Departamentin e Gjuhës dhe Civilizimit Grek; 2) Departamentin e Mësuesisë për Arsimin Parashkollor; 3) Departamentin e Studimeve në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze.

Departamenti i Studimeve në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze, i riemëruar në “Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës” me Vendimin Nr. 23, dt. 11.09.2019 të Senatit Akademik të Institucionit (administruar në MASR me Nr. Prot. 8479, dt. 13.09.2019), që nga fillimi i veprimtarisë së tij, u ngarkua me ofertën e programit të studimit të ciklit të parë, “Bachelor” në “Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze”, program i licencuar me Urdhrin Nr. 192, dt. 20.07.2018 e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ai u krijua me kontributin e akademikëve të njohur, profesorë të Fakulteteve Teologjike të universiteteve ndërkombëtare, në bashkëpunim me teologë e bashkëpunëtorë të “Kryepeshkopatës së Tiranës dhe Gjithë Shqipërisë” dhe është i vetmi në Teologjinë Ortodokse në Republikën e Shqipërisë. Në përputhje me Procesin e Bolonjës dhe si program unik në fushën e studimeve teologjike, hartimi i tij është bazuar në modelet përkatëse ndërkombëtare, përshtatur nevojave aktuale të vendit tonë për një profil të kësaj natyre.

Programi, në gjuhën shqipe, është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara me kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tre) vite akademike. Programi përfundon me marrjen e diplomës “Bachelor” në “Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze”.

Programi i studimit në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze”, me strukturën e përmbajtjen e tij, është në përputhje me fushën akademike të fakultetit, si institucion arsimor në fushën e shkencave humane. Ai synon gërshetimin me shkencat albanologjike, me objektivin për aftësimin teorik dhe praktik të studentëve e përgatitjen e tyre si kadro të specializuar për studimin, menaxhimin dhe promovimin e trashëgimisë së krishterë kulturore në Shqipëri dhe në Europë. Programi ka si qëllim të formojë ekspertë, të aftë për të punuar në organizma arsimorë, socialë, kulturorë, fetare, pranë institucioneve kërkimore dhe organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me qasje ndaj problematikave sociale e kontributit të komuniteteve fetare në nevojat e vendit dhe në dialogun ndërfaqetor e ndërkulturor. Programi ka

si qëllim promovimin e vlerave morale, fetare dhe shoqërore, për të formuar profesionistë, por edhe qytetarë aktivë, të moralshëm dhe inovativë.




Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL me Urdhër Nr. 40, datë 09.06.2021 në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Grupi, në vlerësimin e tij, është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga KU "Logos, dokumentacionin shoqërues të raportit dhe në vizitën organizuar pranë këtij institucioni më 13.07.2021. Po ashtu, Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet ligjore e nënligjore përkatëse, dhe udhëzimet e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në KU "Logos", GVJ ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e institucionit të përfshirë në këtë proces: me strukturat drejtuese të fakultetit dhe departamentit që ofron programin e ciklit të parë "Bachelor" në "Teologji Sociale dhe Shkencat Religjose" nën vlerësim, me anëtarët e departamentit, përfaqësues të zyrave menaxheriale dhe horizontale si të burimeve njerëzore, sekretarisë mësimore, NJSBC, Bibliotekës, si dhe me studentë të programit.

Ecuria e procesit është koordinuar nga Specialisti i ASCAL-it i cili ka asistuar GVJ-në dhe ka koordinuar procesin e mbledhjes së dokumentave shtesë të kërkuara nga GVJ gjatë vizitës në institucion.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit i ciklit të parë “Bachelor” në “Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze” është në përputhje me interesat kombëtare, pasi ka si qëllim përgatitjen e ekspertëve për njohjen e promovimin e trashëgimisë së krishterë kulturore në vend, për studimin e problemeve sociale dhe kontributin e komuniteteve fetare në nevojat e zhvillimit kombëtar, si dhe të rolit të dialogut ndërfaqetor e ndërkulturor në bashkëjetesën e harmoninë sociale në Shqipëri. [ref: Statut i Kolegjit Universitar “Logos”].
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit “Bachelor” në “Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze”, ka si synim përgatitjen e studentëve me nivel bashkëkohor të dijeve përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor, duke kontribuar “në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit”, duke ruajtur e zhvilluar me tej vlerat akademike e kulturore kombëtare. Formimi dhe përgatitja e specialistëve dhe studjuesve në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze” u shërben nevojave aktuale të thellimit e konsolidimit të mëtejshëm të traditës së bashkëjetesës fetare në Shqipëri, frymës së mirëkuptimit, bashkëpunimit e tolerancës fetare, problematikave që lidhen me ruajtjen e forcimin e vlerave e identitetit tonë kulturor e kombëtar. Kurrikula e programit përmban lëndë që u referohen historisë së feve në vendin tonë, të ortodoksizmit, artit e trashëgimisë kulturore të krishterë në Shqipëri, si pjesë e identitetit tonë kombëtar. Edhe veprimtaria kërkimore e shkencore e stafit akademik dhe e studentëve ka në fokus aspekte e problematika që lidhen me ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kulturore kombëtare, mbi qasjen dhe profilin specifik të këtij programi studimi. [ref: Statut i Kolegjit Universitar “Logos”, evid. 8; Misioni dhe Objektivat e programit të studimit].
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit “Bachelor” në “Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze” ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit “për t’i shërbyer shoqërisë nëpërmjet arsimitit e hulumtimit shkencor, nxitjes së zhvillimit individual e sigurimin e suksesit të studentëve në një mjedis global, ofrimin e shërbimeve akademike dhe zhvillimin e një komuniteti të larmishëm dhe gjithëpërfshirës”. Programi ka synim realizimin e një kornizë kurrikulare me qasje ndërkombëtare dhe kombëtare, angazhimin e një stafi akademik me përvojë në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor si brenda ashtu edhe jashtë vendit, pjesmarrje të studentëve në nisma të pavarura (kurrikulare dhe jashtë-kurrikulare) dhe në kërkimin shkencor, partneritet me universitete të huaja perëndimore.

	<p>Programi ofrohet nga Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor dhe është në përputhje me profilin dhe fushën e veprimtarisë së institucionit. [ref: Statut i Kolegjit Universitar “Logos”; Misioni dhe Objektivat e programit të studimit; Mendimi I Dekanit].</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar edhe edhe për të mbështetur e nxitur zhvillimin ekonomik të vendit; ai është në përputhje me përparësitë kombëtare e Strategjinë kombëtare për Zhvillim e Integrim. Kurrikula e programit përmban degë praktike që i shërbejnë aksesit në tregun e punës dhe mundësive për zhvillimin e fushave të reja, si atë të turizmit fetar, nëpërmjet perspektivës së një programi në vazhdim të ciklit të dytë. Synohet të përgatiten ekspertë që do të kontribuojnë në promovimin, menaxhimin e zgjerimin e këtij lloj turizmi, duke iu përgjigjur më cilësisht nevojave të bizneseve turistike në vendin tonë. [ref: Misioni dhe Objektivat e programit të studimit; Mendimi i Dekanit; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Programi i studimit është në përshtatje e në zbatim të Planit Strategjik të Zhvillimit Institucional 2018-2024 dhe përputhet me synimin e tij për t’u shndërruar nga kolegji universitar në universitet. Programi i studimit “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze” synon përmirësimin e vazhdueshëm, brenda kornizës së vizionit të Institucionit, duke ofruar një program të ri studimi të nivelit Master në Turizmin Fetar (aktualisht në fazën e dytë të shqyrtimit për licencim), shtimin e ofertës akademike në nivel pasuniversitar në shërbim të nevojave të të diplomuarve dhe të vizionit të Institucionit për shndërrimin e tij në kategorinë Universitet, zbatimin e partneriteteve ndërkombëtare të Departamentit në drejtim të mobiliteteve dhe fuqizimit të rrjetit të tij, shtimin e mëtejshëm të kapaciteteve të stafit akademik të Departamentit në tituj dhe grada shkencore dhe rritjen e prodhimit shkencore me tregues cilësorë ndërkombëtarë. Tematikat në fokus të veprimtarisë kërkimore e shkencore lidhen si me teologjinë, ashtu edhe me shkencat albanologjike, duke qenë se në kurrikulat e programit të studimit, krahas studimeve teologjike, integrohet edhe studimi i elementeve të kultures shqiptare (historia, arti, traditat, folklori, vlera morale). Me promovimin e vlerave morale, fetare dhe shoqërore, programi i studimit synon të formojë, në zbatim të strategjisë së institucionit, qytetarë aktivë, të moralshëm dhe inovativë. [ref: Plani Strategjik I Zhvillimit të KU “LOGOS” 2018-2024; Plani Strategjik për programin; Misioni dhe Objektivat e programit të studimit; Mendimi i Dekanit].</p>


<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës në lidhje me kriteret e organizimit e të funksionimit të programit të studimit në “Teologji Sociale e Shkencat Religjioze” si dhe të Statutit, Rregullores e Planit strategjik të zhvillimit të KU “Logos”, rezulton se programi aplikohet në përputhje me drejtimit prioritare akademike të përcaktuara. Ai është konceptuar në zbatim të objektivit strategjik të institucionit për t’u dhënë studentëve “njohuritë bazë, mbështetur në metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme si dhe aftësi e kompetenca konkrete sipas llojit të profesionit që karakterizojnë profilin edukativo-kulturor dhe profesional të programit”. Synim i programit të studimit “Studime në Teologjinë Sociale & Shkencat Religjioze” është “të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor”, të përgatisë kuadro të specializuar për “studimin, menaxhimin dhe promovimin e trashëgimisë së krishterë kulturore në Shqipëri dhe në Europë” si dhe “përgatitjen e eksperteve, të aftë për të punuar në organizma arsimorë, socialë, kulturorë, religjiozë, pranë institutive kërkimore dhe organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë”.</p> <p>[ref: Statut i Kolegjit Universitar “Logos”; Rregullore e përgjithshme KU “Logos”; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Rregullore e programit të studimit; Misioni programit të studimit].</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të parë “Bachelor” në “Teologji Sociale e Shkenca Religjioze” ofrohet nga Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, një nga tre departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. Kurrikula e programit ka në fokus thellimin e njohurive në shkencat religjioze, studimin e teologjisë sociale e marrëdhënieve të saj me disiplinat e tjera humanitare si të filozofisë, historisë, arkeologjisë, etj. Programi i studimit, me strukturën e përmbajtjen e tij, është në përputhje me fushën akademike të fakultetit, si institucion arsimor në fushën e shkencave humane. Programi synon gërshetimin me shkencat albanologjike, me objektivin për aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore religjioze në Shqipëri, por edhe në qasjen ndaj problematikave sociale e kontributit të komuniteteve religjioze në nevojat e vendit dhe në dialogun ndërfetar e ndërkulturor.</p> <p>[ref: Statut i Kolegjit Universitar “Logos”; Rregullore e përgjithshme KU “Logos”; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Rregullore e programit të studimit].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë</p>	<p>Dokumentat bazë të institucionit, si plani strategjik e rregullorja e departamentit dhe e programit të studimit, përcaktojnë qartë objektivat për</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al



<p>për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>formimin e studentëve. Në rregulloren e programit, objektiv kryesor vlerësohet formimi i studentëve me “njohuritë bazë, mbështetur në metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme si dhe aftësi e kompetenca konkrete sipas llojit të profesionit që karakterizojnë profilin edukativo-kulturor dhe profesional të programit “Studime në Teologjinë Sociale & Shkencat Religjioze”. Në rregullore përcaktohet synimi i programit : “të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor” duke përgatitur kuadro të specializuar për studimin, menaxhimin dhe promovimin e trashëgimisë së krishterë kulturore në Shqipëri dhe në Europë, ekspertë të aftë për të punuar në organizma arsimorë, socialë, kulturorë, religjiozë, pranë institutive kërkimore dhe organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Edhe nëpërmjet guidës studimore u bëhen të qarta studentëve misioni e objektivat formues, kompetencat dhe aftësitë që përftohen nga ndjekja e programit të studimit. Duke qënë se në fokus të programit është kërkimi shkencor në fushën e teologjisë, studentët, përpara fillimit të procesit mësimor, marrin edhe trajnim për përdoruesit e bibliotekës</p> <p>[ref: Rregullore e programit të studimit; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Plani strategjik për programin; Student guide; RVB; Broshurë e Departamentit; Misioni i programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkuesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Bazuar në takimet me përgjegjësin e departamentit si dhe dokumentacionin përkatës, rezulton se institucioni ka një sistem të organizuar marketingu, nëpërmjet faqes së tij të web-it, mediave sociale, TV e radios, broshurave, fletëpalosjeve, guidave dhe materialeve të tjera informuese. Institucioni organizon gjithashtu aktivitete njohëse e promovuese për programin, si: Open Days, Ditët e informimit dhe këshillimit të karrierës, panaiere, shpërndarje bursash studimi, etj. Aktivitetet studentore janë një mënyrë tjetër e promovimit të programit, ku nëpërmjet konferencave, simpoziumeve, shkollave verore apo aktiviteteve sociale, pasqyrohen kurrikulat, objektivat, perspektivat e vlerat e tij si dhe mundësitë e fushat e bashkëpunimit me partnerët e interesuar. Sipas RVB, për këtë program, plani i marketingut për promovimin e tij dhe rekrutimin e studentëve të rinj “është ngritur në bazë të një krahasimi me analizën që i është bërë tregut si dhe regjistrimeve të një viti më parë duke nxjerrë pikat e forta dhe të dobëta”. Në përpjekje të promovimit të programit, departamenti ka themeluar institucionin e mentorit akademik, me rolin e këshillimit, mentorimit dhe dhënies së udhëzimeve për studentët në lidhje me profilin dhe bagazhin e tyre akademik. Një tjetër veprimtari që zhvillohet në Departamentin e Teologjisë dhe Kulturës është ajo e titulluar "Ndërtoni Karrierën Tuaj", që synon t'i drejtojë studentët në zgjedhjet e duhura për rrugën e tyre universitare dhe t'i përgatisë ata për një karrierë të suksesshme profesionale pas diplomimit, si dhe të kultivojë aftësitë e kërkimit të pozicionit të punës. Lidhur me mundësitë e punësimit të deritanishëm, sipas RVB, programi, duke qënë vazhdim i një seminari teologjik, në pjesën më të madhe u jep mundësi studentëve të rekrutohen, në pozicione të ndryshme, nga KOASH.</p> <p><i>Grupi i ekspertëve të vlerësimit të jashtëm, gjykon se institucioni duhet të llojë më shumë pranë institucioneve shtetërore e private për një akses më të madh punësimi të të diplomuarve pranë tyre sepse edhe misioni i programit është kontributi në fushën e teologjisë sociale nga një qasje ndërdisiplinare, i rolit të fesë së krishterë në kulturë e shoqëri, nga këndvështrime të gjëra sociologjike,</i></p>

	<p>historike, psikologjike, morale, edukative, artistike etj, e rolit të saj në debatin ndërfetar. Në politikën e marketingut të programit, vihet në dukje synimi për “përgatitjen e kuadrove të specializuar për studimin, menaxhimin dhe promovimin e trashëgimisë së krishterë kulturore në Shqipëri...” si dhe për “përgatitjen e eksperteve, të aftë për të punuar në organizma arsimorë, sociale, kulturorë, religjiozë, pranë instituteve kërkimore dhe organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë”. Këto objektiva të programit janë aktuale dhe me interes shoqëror e kombëtar, që i hapin perspektiva mundësive të punësimit të studentëve, por, për këtë, kërkohet më shumë lobim e bashkëpunim i institucionit me partnerë të interesuar shtetërorë e privatë.</p> <p>[ref. Minutat e vizitës; Politika e marketingut e programit të studimit; Plani strategjik për programin, Raport 2021; Plan marketing-CI-Teologji Sociale; Vendim i Departamentit të Teologjisë: Ndërto karrierën tënde; Vendim i Departamentit të Teologjisë: Mentori akademik].</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijes, aftësi, shkathësi dhe kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në Planin Strategjik të Zhvillimit të KU “Logos” theksohet qëllimi që, nëpërmjet programeve të studimit, t’u jepet studentëve “një përvojë arsimore që u ofron atyre mundësinë për të përmbushur potencialin e tyre si individë duke u zhvilluar... si studentë të pavarur të përgatitur për të marrë përgjegjësinë për zhvillimin e tyre personal dhe profesional gjatë gjithë jetës së tyre”. Sipas këtij objektivi, programi i studimit i ciklit të parë “Bachelor” në “Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze”, me objektivat formues, strukturën dhe përmbajtjen, është organizuar t’u japë studentëve njohuritë bazë, mbështetur në metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme si dhe aftësi e kompetenca konkrete, sipas llojit të profesionit që karakterizojnë profilin edukativo-kulturor dhe profesional të programit. Programi i ka të përcaktuara qartë objektivat kryesore formuese, në përputhje me profilin e tij specifik në fushën e teologjisë sociale e shkencave religjioze; është synuar që kurrikula e programit të jetë e bazuar në kompetenca, me në qendër studentin dhe e mbështetur në kërkimin shkencor.</p> <p>Në program është përcaktuar si synim i procesit të mësimdhënies e mësimnxënies, përgatitja e ekspertëve “me aftësi, shkathësi dhe kompetenca që mundësojnë punësimin e tyre dhe u përgjigjen nevojave të tregut”.</p> <p>[ref: Plani Strategjik I Zhvillimit të KU “LOGOS” 2018-2024; Mendimi i Dekanit, programi në Teologji Sociale e Shkenca Religjioze; Plani Strategjik për Programin; Syllabuset, plani mësimor, 2018-2019; Syllabuset, plani mësimor 2019-2020; Syllabuset, plani mësimor 2020-2021].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Nga takimet e GVJ me Dekanin e FSHHKGJ, përgjegjësin e Departamentit të Teologjisë e Kulturës që ofron programin Bachelor në “Teologji Sociale e Shkencat Religjioze”, stafin mësimdhënës e studentë, nga njohja me</p>



<p>për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>dokumentacionin si dhe vizita në mjediset e institucionit, konkludohet se KU “Logos” ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për organizimin e këtij programi studimi. Kolegji, prej vitesh, ka një histori të veprimitarisë së tij akademike; ai ka një mision të qartë për të përmbushur nevojat e arsimit të lartë në fushën e ekonomisë, menaxhimit dhe financës, në informatikë të aplikuar, në trajnimin e teknikëve të laboratorëve mjekësorë, në studime teologjike dhe fetare, në gjuhësi dhe edukim parashkollor. Aktualisht ofron tetë programe studimi Bachelor dhe dy programeve të ciklit të dytë Master Profesional, që sigurojnë përgatitjen e të diplomuarve në fushat më të kërkuara të tregut të punës, në përputhje me tendencat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar. Strukturat për programet e studimit janë të përcaktuara në rregulloret dhe dokumentacionin e kurrikulës. Strukturat e programeve janë në përputhje me objektivat e Procesit të Bolonjës. Institucioni ka një staf akademik të angazhuar edhe në projekte kërkimore dhe botime; “LOGOS” boton revistën e vet shkencore. Institucioni ka zhvilluar strukturat e nevojshme të organizimit e menaxhimit të aktivitetit akademik. Infrastruktura, me godinat e mjediset përkatëse, është e përshtatshme dhe e mirëmbajtur, duke përmbushur normat ligjore për këtë qëllim. Stafi mësimdhënës plotëson kërkesat e kuadrit ligjor për kualifikimin e nevojshëm, ndërsa në veprimtarinë mësimdhënëse e kërkimore marrin pjesë edhe personel akademik me kontratë, të profilit të programit nga universitetet jashtë vendit, me grada shkencore e tituj akademikë. Profesorë vizitorë nga universitetet të huaja, ekspertë të fushave të caktuara të programit të studimit, kanë marrëveshje me institucionin për të kontribuar në realizimin e forcimin e cilësisë së programit akademik.</p> <p>[ref: Minutat e vizitës; Mendimi i Dekanit, programi në Teologji Sociale e Shkenca Religjoze; Plani Strategjik për Programin; RVB; syllabuset e lëndëve; CV e personelit mësimdhënës].</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi “Bachelor” në “Teologji Sociale e Shkenca Religjoze” ofrohet nga një prej tre departamenteve të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, të përbërë prej Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës, Departamentit të Mësuesisë për Arsimin Parashkollor, Departamentit të Gjuhës dhe civilizimit Grek si dhe Qendrës së Kërkimit Shkencor dhe fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të tij. Bazuar në RVB, konfirmohet se “sipas klasifikimit ISCED Fields of Education and Training 2013, me kodin 0221, Shkencat Religjoze dhe Teologjia klasifikohen në fushën e gjërë të Shkencave Humane”.</p> <p>[ref: RVB; Shkencat Humane, Organigrama; Misioni I programit Bachelor “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjoze].</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin përkatës, rezultojnë se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit Bachelor në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjoze” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të departamentit të Teologjisë dhe Kulturës, si njësi përgjegjëse që e ofron këtë program. Bazuar tek kurrikula e programit, syllabuset e lëndëve, CV-të e stafit mësimdhënës si dhe veprimtaria kërkimore e shkencore e realizuar në kuadër të programit, evidentohet, si në fushën akademike, ashtu edhe kërkimore, orientimi i zhvillimit të programit në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë e njësisë bazë në fushën e studimeve teologjike e kulturore dhe, në tërësi, të shkencave humane. Gjithashtu, klasifikimi/kodifikimi i programit të studimit</p>

	sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane mbështetet në vendimin përkatës të senatit të institucionit. [ref: Vendim Senati Akademik Nr. 2, dt. 4.2.2020 “Për miratimin e udhëzuesit për kodifikimin e lëndëve”; RVB, Plani Strategjik për programin; Misioni I programit Bachelor “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5


Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se ka ndarje e zbatim të detyrave, të përcaktuara edhe me rregullore, të njësive e personelit lidhur me organizimin e mbarëvajtjen e programit të studimit. Njësitë bazë, midis të cilave dhe departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, koordinojnë aktivitete me interes të njëjtë kërkimor e shkencor, me pjemarrje të studentëve e pedagogëve; ka bashkëpunim për plotësimin e nevojave për staf mësimor, për promovimin e institucionit, për trajnime dhe shfrytëzimin e mjediseve të përbashkëta. Është krijuar si rregull, në rang fakulteti, mbajtja e takimeve të përmuajshme të Departamentit për të diskutuar çështjet zyrtare, për të informuar stafin mësimdhënës dhe për të marrë vendime të ndërsjella. Këto takime arkivohen në dosje publike për të gjithë, duke hartuar më pas edhe vendimet zyrtare të Departamentit. Kjo praktike pune i shërben vlerësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, progresit në tërësi të Departamentit e në vecanti të njësive përbërëse, nevojave immediate të stafit e ndryshimeve të mundëshme në strategjinë e Departamentit. Nga shqyrtimi i dokumenteve në dispozicion të GVJ, rezulton se ka një praktikë institucionale në departament të vlerësimit të cilësive të shërbimit (të veprimtarisë mësimdhënëse e kërkimore shkencore të personelit akademik, të zhvillimit të provimeve, temave të diplomës e praktikave, të marrëdhënieve me partnerët, të njësive të tjera administrative e ndihmëse të institucionit, të punës së NJSBC-së, etj). Njësitë bazë e përgjegjëse kanë të dokumentuar procedurat dhe analizat e vazhdueshme të punës së tyre. [ref: Minutat e vizitës, Rregullore e Përgjithshme KU “Logos”; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor; Raport periodik analitik i Departamentit; RVB].
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, KU “Logos” ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me një sërë institucione të arsimit të lartë, publike e private brenda e jashtë vendit, institucione të parsimit parauniversitar, institucione të tjera shtetërore e private (joarsimore), aktorë në fushën e biznesit të interesuar për profilet e diplomave të tij. Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës ka marrëveshje zyrtare me Fondacionin “Frymë Dashurie” dhe KOASH për praktikën dhe mundësitë e punësimit të studentëve, ndërsa për rritjen e cilësisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor është përfshirë në Erasmus + KA1, me partner departamentin homolog të

	<p>Universitetit të Finlandës së Veriut. Departamenti bashkëpunon edhe me universitete të tjera në Greqi, Maltë, Rumani, ku profesorë të lëndëve specifike të programit japin mesim apo mbajnë leksione të hapura në mënyrë periodike. Përvojë pozitive Departamenti ka krijuar me zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta, në kuadër të tematikave aktuale të dialogut ndërfaqetar e ndërkulturor, me Departamentin e Studimeve Islame të KU “Beder” dhe Seminarin Katolik të Shkodrës.</p> <p><i>Sidoqoftë, GVJ gjykon se Departamenti mund të bëjë më shumë për zgjerimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione veçanërisht brenda vendit, shtetërore e private, që zgjerojnë aksesin e studentëve në praktikën mësimore por edhe në punësim, si dhe për bashkëpunim në fushën kërkimore e shkencore, duke ofruar tematika me interes të ndërsjelltë e aktuale.</i></p> <p>[ref: Insitucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese; Marrëveshje me “Frymë Dashurie”; Marrëveshje me KOASH; Lista e partneriteteve; UEF Agreement 2019; Aktivitete për vitet akademike 2017-2020].</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni përkatës, rezulton se institucioni “zgjerimin e partneriteteve me institucione vendase dhe të huaja për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve” e ka konsideruar objektiv strategjik, ndërsa ka venë si prioritet “krijimin e një forumi të përhershëm me punëdhënësit”. Vetë Departamenti harton në mënyrë periodike raporte analitike, ku merr në shqyrtim fushat kryesore të veprimtarisë së tij, si atë mësimore, kërkimore-shkencore, procesin e vlerësimit, stafin akademik dhe infrastrukturën. Në raportet vjetore evidentohet edhe ecuria e problematika e bashkëpunimit me partnerët përkatës, ndërsa çështje të kësaj natyre mund të ngrihen edhe në mbledhjet rutinë të departamentit. Pyetësorët e plotësuar nga studentët 2 herë në vit u adresohen problemeve që kanë të bëjnë me funksionimin cilësor e pritshmëritë e programit të studimit.</p> <p>[Ref: Raport Vjetor për veprimtarinë e KU “Logos” 2019-2020; Raport analitik periodik i Departamentit; Pyetësorët; Departamenti i Teologjisë, Pyetësori i Vetëvlerësimit].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Në kuadër të programit të studimit Bachelor në “Teologji Sociale e Shkencat Religjioze”, për kryerjen e praktikave të studentëve, Departamenti ka marrëveshje zyrtare me fondacionin “Frymë Dashurie” dhe KOASH. Mbikëqyrja e mbarëvajtjes së tyre është organizuar duke caktuar persona përgjegjës respektivisht nga departamenti e institucioni pritës. Kjo procedurë vërtetohet me dokumentacion përkatës të nënshkruar nga të dyja palët. Sipas dokumentit përkatës të Departamentit mbi praktikën mësimore, cilësohet se programi i praktikës zhvillohet “në semestrin e dytë të vitit të tretë akademik”, ka 3 ECTS e 75 orë ngarkesë totale për secilin student, ku përfshihen “10 orë bashkëpunim me mentorin...dhe shkrim të një raporti mbi përparimin e tyre dhe 65 orë fizike të trajnimit”. Gjithashtu, në dokument evidentohet, si rregull, se në mënyrë të përvitëshme departamenti ka për detyrë “të njoftojë institucionet me të cilët është arritur një marrëveshje për praktikën e studentëve”, ndërsa studentët paraqiten pranë institucionit të praktikës “me një rekomandim të dhënë nga Departamenti, i cili do të përshkruajë rolin, kushtet dhe afatet e bashkëpunimit të studentit me secilin institucion”. <i>Nga shqyrtimi i listës së insitucioneve pranë të cilave zhvillohet praktika e studentëve të programit Bachelor në “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze”, GVJ është i mendimit se, nisur nga objektivat, pritshmëritë dhe rëndësia e këtij programi</i></p>


	<p><i>studimi, e shpallur edhe në Planin Strategjik të tij, duhet të zgjerohet hapësira e profilit i institucioneve pritëse për praktikën studentore. Për të realizuar e thelluar cilësinë e profilit të programit, ambicjen e promovimit të vlerave fetare e shoqërore e krijimit nëpërmjet tij të qytetarëve “me moral demokratik dhe krijues”, në një kohë, kur në përmbajtjen e tij “tematikat teologjike gërshetohen me shkencat albanologjike”, ndërsa “në kurrikulat e programit të studimit, krahas studimeve teologjike, integrohet edhe studimi i elementeve të kultures shqiptare (historia, arti, traditat, folklori, vlera morale), gjykojmë se ekziston mundësia e duhen bërë përpjekje për një bashkëpunim më të gjërë të departamentit me institucione të tjera, shtetërore, publike dhe private, për t’i dhënë procesit të praktikës një frymëmarrje më të gjërë e efektive.</i></p> <p>[ref: Mendimi Dekanit, Programi në Teologji Sociale e Shkenca Religjose; Misioni dhe Objektivat e programit të studimit; Plani Strategjik për programin; Dokumentat për praktikën; Vendim i Departamentit mbi disa shtesa për praktikën].</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Meqë studentët e parë të diplomuar të programit Bachelor në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjose” i takojnë vitit akademik 2020-2021, trajnimet janë zhvilluar kryesisht përgjatë vitit të tretë akademik. Programi i mentorimit “Ndërto karrierën tënde” i Departamentit ka synuar “t’i ndihmojë studentët të realizojnë mundësitë e tyre akademike dhe profesionale gjatë studimeve por edhe pas diplomimit të tyre..., në mënyrë që t’i përgatisë ata dhe t’i ndihmojë të realizojnë talentet dhe tendencat e tyre që të kuptojnë se cilat janë zgjedhjet e duhura për të ardhmen e tyre, akademike apo profesionale”. Programi i trajnimit përfshin edhe seminare specifike me “udhëzime të përgjithshme për studentët në lidhje me ... rrugën e tyre të ardhshme pas diplomimit”, ku përfshihen shkrimi i CV-së, Deklaratës Personale, kërkimit të punës, përgatitjes së intervistës dhe markës personale, që lidhen me aksesin në punësim e përgatitjen për zgjedhjet e ardhshme, pas diplomimit. Edhe aktivitetet ekstrakurrikulare, si trajnimet “Për përdoruesit e bibliotekës”, për “Edukimin religjioz e TIK” etj, kanë synuar përgatitjen profesionale të studentëve, të vlefshme edhe për zgjedhjet pas diplomimit.</p> <p>[ref: Certifikatë për trajnimin në bibliotekë; Trajnime on-line të studentëve; Raport-perfundimi i trajnimit për Bibliotekën; Raport mbi ecurinë e trajnimit: “Ndërto Karrierën Tëndë”].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me programin e ciklit të parë “Bachelor” në “Teologji Sociale e Shkencat Religjose”, rezulton se ky program studimi, me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara me kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi realizohet në formën e studimeve me kohë të plotë dhe përfundon me marrjen e diplomës. Sic është përcaktuar edhe në dokumentin mbi misionin dhe objektivat e programit, organizimi i tij “realizohet nëpërmjet moduleve dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS). Një kredit universitar përkon deri me 25 orë pune të studentit, përfshirë këtu dhe kohën për studim individual. Ngarkesa vjetore e punës së një studenti me kohë të plotë është 60 kredite. Programi realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tre) vite akademike [ref: Planet mësimore; Rregullorja e programit; Misioni dhe objektivat e programit; RVB].</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Në dokumentacionin përkatës të programit, përcaktohet si objektivi kryesor i tij synimi që “t’u japë studentëve njohuritë bazë, mbështetur në metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme si dhe aftësi e kompetenca konkrete sipas llojit të profesionit që karakterizojnë profilin edukativo-kulturor dhe profesional të programit”. Nga shqyrtimi i planeve mësimore e sylabuseve të lëndëve, rezulton se lëndët e programit, të grupuara në 5 fusha specifike si: Studime Biblike, Studim i Religjionit, Teologji Dogmatike, Studime Patristike & Histori e Kishës, Etikë dhe Edukim i Krishterë, në tërësi, synojnë përgatitjen e studentëve me shprehje e aftësi në drejtim të realizimit të objektivave të programit për ekspertë në profile e specialitete të gjëra, të lidhura me këtë program studimi. Nëpërmjet këtyre lëndëve jepen njohuri mbi marrëdhëniet e teologjisë sociale me shkencat e tjera, mbi historinë e Kristianizmit Ortodoks dhe shkencat religjioze, mbi religjionin nga pikëpamja sociale, psikologjike, filozofike, historike dhe e së drejtës, mbi aftësimin teorik dhe praktik për mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore religjioze të Shqipërisë, mbi probleme sociale dhe kontributin e komuniteteve religjioze në nevojat e zhvillimit të Shqipërisë moderne si dhe në dialogun ndërfaqësor. Programi synon të formojë “ekspertë të specializuar për studimin, menaxhimin dhe promovimin e trashëgimisë së krishterë kulturore në Shqipëri dhe në Europë”, të aftë të kontribuojnë në “organizma arsimorë, socialë, kulturorë, religjiozë, pranë institutive kërkimore dhe organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë”. [ref: Rregullore e Programit të Studimit; Misioni dhe Objektivat e Programit të Studimit; Plani Strategjik për Programin-Raport 2021].</p>



<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit Bachelor “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze”, planet mësimore e sylabuset e lëndëve, si dhe nga biseda me stafin akademik dhe studentët e diplomuar, rezultojnë se ky program synon të japë një qasje të zgjeruar dhe të specializuar të koncepteve e çështjeve themelore në fushën teologjike e shkencave religjioze si dhe fushave të tjera të lidhura me to e të përcaktuara në program. Ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese (A, B, C, D, E), por edhe përmbajtja e tyre me literaturën përkatëse, synon qasjen kritike të teorive dhe parimeve akademike të fushës së studimit, duke u dhënë mundësi studentëve të aftësohen për zhvillim karriere. Në RVB jepen si shembull, nga programi, lëndë që japin njohuri e aftësi bazë (“Hyrje në Studime Religjioze”, “Hyrje në Dhjatën e Re”, etj) si dhe lëndë me njohuri e kompetenca më të avancuara apo lëndë që ndërthurin teorinë më praktikën (“E drejta Kanonike”, “Studime Sistematike në Teologji”, etj). Përgjatë zhvillimit të programit, me lëndët përkatëse, studentët përvetësojnë bazën e nevojshme teorike për të patur qasjen e duhur në çështje të natyrës praktike, të etikës, edukimit, interpretimit të mendimit teologjik e tendencave të shoqërisë.</p> <p>[ref: Minutat e Vizitës; Rregullore e Programit të Studimit; Sylabuset e Planet mësimore; RVB].</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga biseda me stafin akademik të programit, studentët por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, evidentohet se programi përfshin në kurrikulën e vet lëndë që lidhen me fusha praktike si të teologjisë (Edukimi I Krishterë, Edukimi Religjioz, Puna Baritore, Sociologjia e Zbatuar e Religjonit dhe Krishterimit), ashtu edhe të fushave të tjera të etikës, edukimit, pedagogjisë, etj. Gjithashtu, në shumicën e lëndëve, në sylabuset e tyre është përcaktuar në formë detyruese realizimi i projekteve ose punimeve me tematika të specializuara e profesionale, që i ndihmon studentët të zhvillojnë shprehje e aftësi për qasjen e zgjidhjen e problemeve në terrenin praktik.</p> <p>[ref: Minutat e Vizitës, Sylabuset e Planet mësimore; RVB].</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, sylabuseve të lëndëve, rezultojnë se programi i ciklit të parë “Bachelor” në “Teologji Sociale e Shkencat Religjioze” i përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit. Rregullorja mësimore e programit mbështetet në Ligjin Nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” e në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Struktura e studimeve për programin “Studime në Teologjinë Sociale & Shkencat Religjioze” përfshin: proces mësimor, praktikë profesionale, përgatitje e punimit të diplomës / apo provimit të përgjithshëm përfundimtar. Format e punës mësimore janë parashikuar në planin mësimor të programit dhe janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit, praktikat profesionale, testet, provimet semestrale dhe mbrojtja e diplomës ose provimi i përgjithshëm përfundimtar. Disiplinat që zhvillohen në programin “Studime në Teologjinë Sociale & Shkencat Religjioze” janë disiplina të formimit bazë, disiplina karakterizuese të programit të studimit, disiplina të ngjashme/integruese që lidhen me disiplinat karakterizuese, disiplina me zgjedhje nga studenti të disiplinave të ofruara prej institucionit dhe njohuri</p>

	të tjera formuese. Lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur. [ref: Rregullore e Programit të Studimit; Syllabuset e Planet mësimore].			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga shqyrtimi i rregullores së programit e syllabuseve të lëndëve rezulton se në strukturën e programit janë të qarta ndarjet e veprimtarive formuese që ofrohen në këtë program studimi. Ato grupohen në kategoritë e përcaktuara të veprimtarive formuese, si: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese e detyrimet përmbyllëse, me ngarkesën përkatëse në kredite, bazuar tek VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Gjithashtu, programet specifike të cdo lënde janë në përputhje me udhëzimet për këtë qëllim dhe përfshijnë: pjesën përshkruese, tipin e lëndës, llojin e lëndës, kreditet, kodin si dhe adresën elektronike të pedagogut. Në vazhdim janë: zëri i përmbledhjes dhe rezultatit të të nxënit, konceptet themelore, temat e lëndës, forma e kontrollit të dijes, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura si dhe zëri i vërejtjeve përfundimare nga pedagogu i lëndës. [ref: Rregullore e Programit të Studimit; Syllabuset e Planet mësimore; RVB].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Referuar dokumentacionit të institucionit dhe RVB, konstatohet se Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, përgjegjës për programin e ciklit të parë “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjose”, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Programi ka qenë pjesë e ofertës akademike të këtij departamenti, përbërës i strukturës së Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor që nga krijimi. Një nga tre Fakultetet e Kolegjit Universitar LOGOS (licensuar me VKM Nr. 1055, dt. 29.07.1999, i njohur me Statusin e Kolegjit Universitar me Urdhrin Nr. 93, dt. 06.03.2017 e Ministrit të Arsimit dhe Sportit), Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor u licensua me Urdhrin Nr. 408, dt. 13.07.2018 e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke pasur në përbërjen e tij tre departamentet: të Gjuhës dhe Civilizimit Grek, të Mësuesisë për Arsimin Parashkollor dhe të Studimeve në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze. Departamenti i Studimeve në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze, i riemëruar si “Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës” me Vendimin Nr. 23, dt. 11.09.2019 të Senatit Akademik të Institucionit (administruar në MASR me Nr. Prot. 8479, dt. 13.09.2019), që nga fillimi i veprimtarisë së tij, u ngarkua me ofertën e Programit të Studimit Bachelor në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze, program i licensuar me Urdhrin Nr. 192,

	<p>dt. 20.07.2018 e Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sipas RVB, departamenti ka në përbërje 7 pedagogë me kohë të plotë, prej të cilëve 5 janë me tituj/grada shkencore. Kurrikula e programit është organizuar që të ndërthurë formimin teorik me formimin shkencor e përvojën praktike dhe krijon bazën për studime të mëtejshme universitare dhe integrim me tregun e punës. Departamenti realizon proces të vazhdueshëm vlerësimi të brendshëm e përmirësimi, si në veprimtarinë mësimdhënëse, ashtu edhe kërkimore e shkencore e të kualifikimit të stafit akademik.</p> <p>[ref: Mendimi I Dekanit mbi programin e Studimit; Urdhër Nr.192, dt.20.04.2018 për hapjen e Programit të Studimit; Misioni dhe objektivat e programit; Plani Strategjik për programin; Rregullore e Programit të Studimit; RVB].</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Sipas RVB e dokumentacionit përkatës, programi i studimit ka në rolin e koordinorit vetë drejtuesin e Departamentit, i cili “koordinon e monitoron progresin e programit dhe të studentëve”. Në mbledhjet dhe analizën vjetore të departamentit, raportohet për mbarëvajtjen e programit dhe të punës së departamentit, duke u ndalur në problemet që lidhen me infrastrukturën, stafin akademik, kurrikulën e mësimdhënies, shërbimet mësimore-studentore, administrimin, vlerësimin, programet akademike dhe kërkimore. Për mbarëvajtjen e komponentëve të tjerë të programit, u delegohen detyra anëtarëve të tjerë të departamentit; me vendim departamenti për programin e praktikës janë caktuar pedagogë mbikëqyrës. Gjithashtu departamenti ka krijuar edhe institucionin e mentorit akademik, që ka rolin e “këshillimit, mentorimit dhe dhënies së udhëzimeve për studentët në lidhje me profilin dhe prejardhjen e tyre akademike, studimet e tyre gjatë programit bachelor dhe pas diplomimit të tyre, vendimin e tyre për tezën dhe përgjithësisht gjithçka që duhet të bëjnë për përmirësimin e tyre gjatë secilit vit akademik”. Departamenti ka organizuar edhe programin trajnues "Ndërto karrierën tënde" që nëpërmjet këshillimit e udhëzimit të personave përgjegjës, u vihet më efektivisht në ndihmë studentëve lidhur me zgjedhjet e duhura për rrugën universitare e përgatitjen për një karrierë profesionale të suksesshme pas diplomimit.</p> <p>[ref: RVB; Vendim i Departamentit të Teologjisë e Kulturës “Ndërto Karrierën Tënde”; Vendim I Departamentit për Mentorin Akademik; Vendim I Departamentit “Për disa shtesa në Vendimin e Praktikës”; Rregullore e Diplomimit; Raport mbi ecurinë e Programit të Trajnimit “Ndërto karrierën tënde”].</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të KU “Logos”, rezulton se, si njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, ashtu edhe njësia bazë, pjesë e strukturës së tij, Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës që ofron programin “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze”, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti në fjalë funksionon si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe e punës kërkimore-shkencore të Fakultetit; ai nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore edhe lidhur me programin në fjalë. Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, në përputhje me kërkesat ligjore, ka në përbërje të tij 7 anëtarë të punësuar me kohë të plotë si personel akademik, nga të</p>

	<p>cilët 5 me grada/tituj shkencorë. Gjithashtu, ka në përbërje edhe personel administrativ si sekretaria mësimore, që administrojnë dhe mirëmban dokumentacionin arsimor. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukurore të tij. Ai propozon edhe kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e Ligjit për Arsimin e Lartë e akteve nënligjore. Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e institucionit. Rregulla të tjera për strukturën dhe funksionimin e departamentit përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit si dhe të Fakultetit përkatës të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.</p> <p>[ref: Statut i Kolegjit Universitar “Logos”; RRegulloret e Përgjithshme KU “Logos”; Rregulloret e Fakultetit të Shkencave Humane; Raport periodik analitik i Departamentit 2021].</p>			
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Departamenti I Teologjisë dhe Kulturës, si njësia përgjegjëse për programin “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze” përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Në përbërje të tij janë 7 anëtarë të përhershëm si personel akademik, me tituj e grada shkencore, nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 4 me gradë Dr/PhD (të fituar jashtë vendit), 2 me MSC, ku njëri është në proces doktorature. Lektorët mbulojnë lëndë në përputhje me kualifikimet dhe interesat e tyre të kërkimit shkencor.</p> <p>[ref: Raport periodik analitik i Departamentit 2021; Cilësia e stafit mësimdhënës; Të dhëna për kualifikimin e stafit].</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor përbëhet nga tre departamente (Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek, Departamenti i Mësuesisë për arsimin parashkollor, Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës), duke iu përmbajtur kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë. Struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin, rregulloren dhe aktet e tjera të institucionit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, si njësia përgjegjëse për programin e studimit, i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Ka 7 anëtarë efektivë, prej të cilëve 5 me grada/tituj shkencorë dhe 1 në proces doktorature si dhe personel përkatës administrativ. Departamenti, për realizimin e procesit mësimor, ka gjithashtu në funksion të veprimtarisë mësimdhënëse edhe 5 profesorë vizitorë, 5 lektorë me kohë të pjesshme dhe 5 lektorë të përhershëm, që i përkasin Departamenteve të tjera të Universitetit “Logos” për lëndën e Gjuhës Greke, Gjuhën Angleze, Informatikën, Shkrimin Akademik dhe Pedagogjinë, duke mbuluar të gjitha nevojat për çdo lëndë dhe kurset e programit.</p> <p>[ref: Rregulloret e Departamentit; Të dhëna për personelin akademik në programin e studimit; Raport periodik analitik i Departamentit 2021; Cilësia e stafit mësimdhënës; Të dhëna për kualifikimin e stafit].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni disponon informacionet e nevojshme mbi programin e studimit, strukturën, përmbajtjen dhe organizimin e saj. Rregullorja e fakultetit, departamentit dhe e programit të studimit, misioni e plani strategjik për programin, rregullorja e diplomimit, planet mësimore me sylabuset përkatëse të lëndëve, marrëveshjet me institucionet dhe organizatat bashkëpunuese e partnerët, rregullorja e provimeve, transferimeve, praktikës, informacionet për trainimet e studentëve e aktivitetet ekstrakurrikulare si dhe mundësitë e orientimit dhe këshillimit për karriere, etj janë pjesë e dokumentacionit të gjerë që disponon departamenti. Gjithashtu, dokumenta të tjera janë në shërbim të marketingut të programit, si guida për studentët dhe botime të tjera të promovimit të tij. Informacionet janë të publikuara përmblendhtazi edhe në website e institucionit e të departamentit. (https://theolkulogosalb.ëordpress.com). Departamenti promovon punën edhe në median sociale nëpërmjet postimeve, skedarëve video dhe audio. Ka llogari (account) zyrtare në Facebook, Instagram, LinkedIn, YouTube, Soundcloud, Issuu, Tik Tok dhe Viber.) (https://theolkulogosalb.ëordpress.com platforma për arsimim asinkron https://theolkulogos.neolms.eu/ është një pikë referimi për studimet në Departament, ku janë postuar përmbajtje të specializuara arsimore, materiale të pasura udhëzuese dhe ushtrime për secilin kurs, si dhe Biblioteka online. Dokumentacioni i procesit mësimor për Departamentin e Teologjisë dhe Kulturës plotësohet, ruhet dhe administrohet nga zyra e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>[ref: Rregullore e KU “Logos”; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor; Rregullore e Departamentit të Teologjisë dhe kulturës; Rregullore e programit të studimit; Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Planit Strategjik për Programin; Guida për studentët; Syllabuset e Planet mësimore 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021].</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, programi “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze” është organizuar në veprimtari formuese, të grupuara në lëndë bazë të programit të studimit, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese, praktike profesionale e detyrime përmblyëse. Disiplinat grupohen mbi bazën e objektivave të tyre formuese, duke respektuar raportet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Sipas rregullores së programit, veprimtaritë formuese realizohen nëpërmjet mësimimit në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë), studimit individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>punimit të diplomës/provim formimi) dhe praktika profesionale. Në planin mësimor të programit përrcaktohen lëndët, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, në vite e semestra, me kreditet përkatëse.</p> <p>[ref: Syllabuset e Planet mësimore 2018-2019,2019-2020, 2020-2021].</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjose”, GVJ konstaton se lëndët dhe modulet e programit janë të vlerësuara më kredite, sipas sistemit vendas dhe evropian, të ndara në 6 semestra me kohëzgjatjen 3 vjecare e që plotësojnë numrin total të 180 krediteve evropiane (ECTS). Sipas rregullores së programit, një kredit universitar përkon deri me 25 orë pune të studentit, përfshirë këtu dhe kohën për studim individual. Ngarkesa vjetore e punës së një studenti me kohë të plotë është 60 kredite. Në përlllogaritjen e orëve të kreditit përfshihen edhe koha për përgatitje dhe punë të pavarur të studentit, duke konsideruar rreth 13-15 orë për studim individual. Shpërndarja e krediteve sipas veprimtarive formuese, brenda një disipline, përcaktohet nga Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, në funksion të natyrës së disiplinës. Në programin e studimit jepet numri i provimeve dhe formave të tjera të vlerësimit përfundimtar të dijeve të fituara në çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.</p> <p>[ref: Rregullore e programit të studimit; Planet mësimore].</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores e planit mësimor të programit Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjose”, GVJ vëren se në to përmbahet informacioni i duhur për ngarkesën mësimore, orët brenda dhe jashtë auditorit, ngarkesa totale e ndarë në leksione, seminare, ushtrime/projekt/detyra, praktike e punim diplome, format e kontrollit të njohurive, elementët ku bazohet nxjerrja e notës përfundimtare. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Sipas RVB, “orët maksimale për tre vitet e studimit janë 4500, nga të cilat 1780 janë orë brenda auditorit, ndërsa 2720 janë orë të përcaktuara si jashtë auditorit”. Totale. Programi mësimor i lëndës jep në formë të përmbledhur strukturën e lëndës; përmbajtjen, orët përkatëse në auditor, duke i specifikuar në leksione dhe seminare, njohuritë paraprake të nevojshme për ndjekjen e lëndës, kushtet e veçanta në lidhje me frekuentimin dhe shlyerjen e detyrimeve para formës përfundimtare të vlerësimit, mënyrën e vlerësimit, bibliografinë e rekomanduar, e cila duhet të përmbajë autorë dhe tituj përfaqësues të njohur për disiplinën përkatëse. Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës e miratohet, pasi konsultohet në department.</p> <p>Vlerësimi bazohet në rregulloren e programit.</p> <p>[ref: Rregullore e programit të studimit; Planet mësimore; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor].</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së programit të studimit e dokumentave të tjera të posacme, GVJ konstaton se në to studentët mund të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit, njohjes së krediteve dhe kushteve të mobilitetit të studentëve. Pikat kryesore të përmbajtjes së programit janë: të dhëna të përgjithshme për programin, formën dhe objektivat kryesore, planin mësimor shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve;</p>

	<p>metodat e vlerësimit të studentëve, etj. Gjithashtu, lidhur me kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, institucioni aplikon Rregulloren e posacme të transferimeve që parashikon të gjithë hapat e procedurën e duhur për këtë qëllim.</p> <p>[ref: Rregullore e programit të studimit; Planet mësimore; Syllabuset e lëndëve; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor; Rregullore e transferimeve].</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores e syllabuseve të lëndëve të programit të studimit Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjose”, GVJ konstaton se ato i përmbahen VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL (ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019). Format i syllabusit të lëndës dokumenton në mënyrë të detajuar informacionin mbi rezultatet e pritshme të të nxëniet, konceptet themelore, temat shoqëruar me literaturën e detyruar dhe të rekomanduar, kushtet e frekuentimit, formën e kontrollit të dijes dhe komponentet e tjerë formues të programit.</p> <p>[ref: Rregullore e programit të studimit; Syllabuset e lëndëve; Planet mësimore; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor].</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, GVJ konstaton se ajo parashikon rishikim në mënyrë periodike të programit të studimit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm. Rishikimi i programit mund të parashikojë bashkime lëndësh ose ndarje të tyre, por pa cenuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në program, rishikimin e krediteve të lëndëve, të teksteve që do të përdoren por edhe të literaturës. Ndryshimet propozohen nga Departamenti dhe, si rregull, rishikimi mund të bëhet vetëm para fillimit të vitit akademik. Sipas dekanit të departamentit të Teologjisë dhe Kulturës, lidhur me programin e studimit “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjose”, “ndryshimet kurrikulare në masë deri më 20%, të kryera në përfundim të një procesi rishikimit të kurrikulave, të miratuar me Vendimin (Nr. 19, dt. 27.03.2019) të Senatit Akademik të KU “Logos”, si dhe ndryshimet cilësore në vlerësimit të studentëve të reflektuar në përmbajtjen e programeve të lëndëve” janë “hapa drejt përmirësimit të këtij programi”. Materialet e takimeve të përmuajshme zyrtare të Departamentit, ku diskutohen çështjet zyrtare, informohet stafin mësimdhënës dhe merren vendime përkatëse, arkivohen nga sekretarja, e cila ka përgjegjësinë e arkivimit të dosjes së plotë ku përfshihen edhe vendimet zyrtare të Departamentit. Në këtë mënyrë bëhet e mundur të vlerësohet në vazhdimësi procesi e cilësia e mësimdhënies, progresi i departamentit, nevojat e sugjerimet e stafit dhe ndryshimet në strategjinë e njësisë bazë.</p> <p>[ref: Mendimi i Dekanit; Procedurë e ndryshimit të Kurrikulës me 20%; Vendim Departamenti, Ndryshimi i programeve me 20%; Rregullore e programit të studimit].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të ciklit të parë “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Studime Religjose”, konstatohet se ngarkesa e tij është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi e udhëzimet e MASR. Plani mësimor i programit është bazuar në Ligjin Nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Rregulloren e posacme të programit dhe Kalendarin Akademik të KU “Logos”. Organizimi i programit realizohet nëpërmjet moduleve dhe Sistemit European të Transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS). Një kredit universitar përkon deri me 25 orë pune të studentit, përfshirë këtu dhe kohën për studim individual. Ngarkesa vjetore e punës së një studenti me kohë të plotë është 60 kredite. Programi i studimit “Studime në Teologjinë Sociale & Shkencat Religjose” realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tre) vite akademike; Në përlllogaritjen e orëve të kreditit përfshihen edhe koha për përgatitje dhe punë të pavarur të studentit, duke konsideruar rreth 13-15 orë për studim individual. Ngarkesa e përgjithëshme vjetore është jo më pak se 1500 orë. Cdo semestër ka 15 javë mësimore ndërsa ngarkesa javore është deri 20-25 orë, me kohëzgjatje 50 minuta. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur temën e diplomës/provimin e përgjithshëm përfundimtar, pajiset nga kolegji me diplomën “Bachelor” në programin “Studime në Teologjinë Sociale & Shkencat Religjose”, të shoqëruar me suplementin e diplomës. [ref: RVB; Rregullore e programit të studimit; Plani mësimor BA Teologji Sociale].</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, rezulton se emërtimi e përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë njohuri dhe aftësi për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve. Struktura e studimeve për programin “Studime në Teologjinë Sociale & Shkencat Religjose” përfshin: proces mësimor, praktikë profesionale, përgatitje e punimit të diplomës / apo provimit të përgjithshëm përfundimtar. Format e punës mësimore janë parashikuar në planin mësimor të programit; Ato janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit, praktikat profesionale, testet, provimet semestrale dhe mbrojtja e diplomës/ provimi i përgjithshëm përfundimtar. Disiplinat që zhvillohen në programin “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjose” janë disiplina të formimit bazë, disiplina karakterizuese të programit të studimit, disiplina të ngjashme/integruese që lidhen me disiplinat karakterizuese, disiplina me zgjedhje nga studenti të disiplinave të ofruara prej institucionit dhe njohuri të tjera formuese. Ndarja e programit në 5 sektorë: Studime Biblike, Studim i Religjionit, Teologji Dogmatike, Studime Patristike dhe Histori e Kishës, Etikë dhe</p>

	<p>Edukim i Krishterë, përfshin lëndët bazë dhe formimin e duhur teorik e praktik për aftësimin e studentëve për karrierën pas diplomimit. Edhe në Planin Strategjik të departamentit cilësohet se programet janë në funksion të punësimit të studentëve, që ata “pas diplomimit, të japin shërbimet e tyre në disa sektorë dhe vende pune dhe ... të ndjekin edhe një karrierë akademike”</p> <p>[ref: Rregullore e programit të studimit; Syllabuset e planet mësimore 2018-2019,2019-2020,2020-2021; Plani Strategjik i departamentit].</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se shpërndarja e lëndëve në vite e semestra, me kreditet e orët mësimore përkatëse, përputhet me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është në funksion të objektivave formuese të programit e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Organizimi i shpërndarjes së lëndëve në 5 sektorët kryesorë të Teologjisë u ka shërbyer njohjes dhe përvetësimit të duhur të aspekteve kryesore të Studimeve Teologjike: Studimet biblike 20%; Studimi i Fesë 15%, Teologjia Dogmatike 30%, Studime Patristike dhe Histori e kishës 20% dhe Etikë e Edukim Fetar 15%. Kjo ka ndihmuar për një qasje holistike të programit, ndërsa në programin e praktikës të përvetësohen disiplinat praktike të Teologjisë, si Edukim i Krishterë, Edukim Religjuz, Punë Baritore, Sociologji e Zbatuar e Religjonit dhe Krishterimit.</p> <p>[ref: RVB; Raport periodik analitik 2020-2021; Mendimi i Dekanit].</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të ciklit të parë “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze”, kurrikula e programit, sylabuset dhe planet mesimore të tre viteve, konstatohet se struktura e tij, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë janë hartuar bazuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Shtojca nr.1, Tab.nr.1, i ndryshuar. Ato janë në përputhje e me synim të realizimit të objektivave të programit. Sipas Dekanit, “programi i studimit Bachelor në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze është i vetmi në Teologjinë Ortodokse në Republikën e Shqipërisë. Rrjedhimisht, në mospasjen e modeleve më të vjetra kurrikulare në këtë fushë brenda vendit, Departamenti dhe Programi i Studimit nën shqyrtim, janë të detyruar t’u referohen modeleve përkatëse ndërkombëtare, duke marrë në këtë mënyrë një orientim ndërkombëtar”.</p> <p>[ref: RVB; Mendimi I Dekanit; Syllabuset e Planet mësimore].</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës mbi programin, rezultojnë se organizimi i tij sipas llojit të veprimtarive formuese (A,B,C, D, E) me lëndët bazë të formimit të përgjithshëm e përgatitjes metodologjike, lëndët e formimit specifik, ndërdisiplinore e integruese; të veprimtarisë praktike e detyrimeve përmblylëse etj, dhe përcaktimi i raporteve midis formimit teorik dhe praktik i shërben arritjes së objektivave formuese, transferimit të studimeve, mobilitetit dhe punësimit në përfundim të studimeve. Vendosja në kurrikulën e programit të një sërë lëndesh nga shkencat shoqërore u shërben objektivave më të gjera të programit për studimin i marrëdhënieve të teologjisë sociale me shkencat e tjera, për qasjen ndaj religionit nga pikëpamja sociale, psikologjike, filozofike, historike etj, për mbrojtjen dhe promovimin e objekteve të trashëgimisë</p>

	<p>kulturore të krishterë në vend, etj. Në rregulloren e programit përcaktohet gjithashtu se “Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, që ofron programin “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze”, në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 80/2015, si dhe me sistemin e krediteve të ndërtuara sipas parimeve të Kartës së Bolonjës ofron mundësi për transferimin e studentëve në vite të ndërmjetme, që vijnë nga institucione publike apo private të arsimit të lartë vendas apo të huaj ku zhvillohen programe të ngjashme studimi universitare të ciklit të parë. Institucioni lejon gjithashtu transferimin e studentëve të tij në institucione të tjera të arsimit të lartë vendas apo të huaj...”.</p> <p>[ref: Statuti I KU “Logos”; Rregullore e programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, vizita në Bibliotekën e institucionit e biseda me stafin pedagogjik të programit, GVJ konstaton se lëndët që zhvillohen për gjatë tre viteve akademikë në programin Bachelor në “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze” bazohen në literaturë të detyruar e ndihmëse edhe të viteve të fundit, botuar nga shtepi të njohura botuese. Vetë institucioni disponon një bibliotekë të pasur në shërbim të programit; ajo ka në total 17453 tituj librash teologjikë dhe jo teologjikë, fjalorë dhe enciklopedi dhe botime të tjera në formë CD, audio, DVD, etj. Nga to, 507 tituj të rinj janë në shqip, të tjerë në anglisht, greqisht e gjuhë të ndryshme si dhe një numër periodikësh vinë rregullisht, si në gjuhë të huaj, edhe shqip.</p> <p>Në tërësi, përmbajtja e lëndëve dhe syllabuset përditësohen, si një kusht i detyruar i vënë nga departamenti, duke u azhurnuar edhe me tendencat e qasjeve moderne e shkencore në disiplinat teologjike e shkencat religjioze. Sidoqoftë nuk përjashtohet edhe fakti se, për natyrën e një sërë lëndëve, materialet dhe librat u takojnë veprave klasike në fushën e teologjisë. Ndërkaq, departamenti ka filluar edhe procesin e botimit të librave dhe materialit të ri arsimor për studentët e programit “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze”, tekste e monografi nga profesorët që janë pjesë e procesit mësimdhënës. Nga viti akademik 2019-2020 janë botuar 9 libra të tilla si dhe përkthime botimesh në shqip. Sipas RVB, “pothuajse cdo lëndë përdor botime të reja dhe material prototip ekskluziv për lëndët e këtij programi studimi”. Ndër botimet e-book të departamentit figurojnë: “Formimi dhe Edukimi i krishterë”, “Jeta në Krishtin”, “Hyrje në Studimet Religjioze”, “Shkrim Akademik”, “Fetë e Botës” “Udhëzues Karriere”, “Rrymat Filozofike” etj. Janë krijuar seri me artikuj dhe kapituj librash të përkthyer në shqip si dhe është krijuar, që nga ky vit akademik, revista akademike “Teologjia dhe Kultura”, që botohet dy herë në vit, ndërkombëtare, e recensuar, me artikujve shkencorë në fushën e Teologjisë, Studimit të Religjionit, Edukimit, Shkencave Sociale, etj.</p> <p>[ref: Syllabuset e lëndëve, RVJ; revista akademike “Theology and Culture”; e-Libra Cover; Biblioteka “Ngjallja” total; Titujt e rinj 2018-2021; Periodikët; Didaktikë për Teologjinë; Kërkesë për libra].</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Nga biseda me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik të programit dhe studentët, si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës, GVJ është i mendimit se përmbajtja e programit “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze” garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe</p>

	<p>kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Kjo del në pah nga shqyrtimi i organizimit të kurrikulës, përmbajtjes së lëndëve, literaturës, programit të praktikës e aktiviteteve të tjera kurrikulare dhe ekstrakurrikulare që shoqërojnë formimin e përgatitjen e studentëve përgjatë tre viteve akademike. Objektivi kryesor i programit është “t’u japë studentëve njohuritë bazë, mbështetur në metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme si dhe aftësi e kompetenca konkrete sipas llojit të profesionit që karakterizojnë profilin edukativo-kulturor dhe profesional të programit. Synimi i tij është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor”. Kurrikula me qasje ndërkombëtare, cilësia e stafit mësimdhënës me angazhimin edhe të profesorëve të huaj, ekspertë në një sërë disiplinash të programit, ka impak tek studentët për përvetësimin e njohurive, metodave të studimit, aftësive dhe kompetencave që plotësojnë pritshmëritë e një programi studimi të ciklit të parë. [ref: Minutat e Vizitës; Syllabuset e lëndëve; Plani mësimor i programit; Misioni dhe objektivat e programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga takimet me dekanin dhe përgjegjësën e departamentit të Teologjisë dhe Kulturës që ofron programin e studimit si dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se programi është konceptuar e organizuar për të mundësuar vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Në misionin e objektivat e programit “bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjose” vihet në dukje se “specialistët që përfundojnë “Studime në Teologjinë Sociale & Shkencat Religjose” e që kanë interes për zhvillimin e njohurive në këtë fushë kanë të drejtë të thellojnë njohuritë e tyre nëpërmjet kualifikimeve të mëtejshme në ciklin e dytë “Master Profesional” dhe “Master Shkencor” brenda apo jashtë vendit”. Departamenti ka synuar të forcojë cilësinë e zhvillimit të programit përgjatë tre viteve akademike dhe t’i përgatisë studentët, edhe me aktivitete të tjera kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, seminare e trainime për përparimin në vijimin e studimeve. Kështu, vec pjesmarrjes në procesin mësimor, departamenti ka punuar edhe për angazhimin e studentëve në nisma të pavarura dhe kërkimi shkencor, në përfshirjen e tyre në takime ndërkombëtare si përfaqësues të rinisë së Kryepeshkopatës, në pjesmarrjen, bashkë me personelit akademik, në veprimtari shkencore, botime të departamentit e botime jashtë. Edhe lidhjet e Departamentit dhe programit të studimit me universitete të huaja perëndimore, si Universiteti i Finlandës Lindore, në kuadrin e programeve ERASMUS+, KA1. i shërbejnë forcimit të cilësisë së përgatitjes së studentëve. Departamenti, në planin e tij strategjik, e konsideron shumë të rëndësishëm objektivin e shtimit të ofertës akademike në nivelin Master dhe pasuniversitar, në shërbim të nevojave të të diplomuarve dhe të vizionit të Institucionit për shndërrimin e tij në kategorinë Universitet. [ref: Minutat e Vizitës; Plani Strategjik për Programin; Raporti analitik periodik].</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me</p>	<p>Nga biseda e GVJ me drejtuesit e departamentit e stafin pedagogjik, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se përmirësimi i</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

përmbajtjes së programit të studimit është në vemendjen dhe objektivat e departamentit. Në të vërtetë, programi i studimit “Bachelor” në “Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze” është i vetmi në Teologjinë Ortodokse në vend, ndaj, sic pohohet nga Dekani i Fakultetit, duke mospatur modele kurrikulare, “Departamenti dhe Programi i Studimit u janë referuar modeleve përkatëse ndërkombëtare, duke marrë në këtë mënyrë një orientim ndërkombëtar”. Ndërkaq, institucioni konsideron si pika të forta të veprimtarisë së tij jo vetëm kornizën kurrikulare, por edhe tërheqjen e profesorëve të huaj të kualifikuar, angazhimin e studentëve në nisma të pavarura kurrikulare dhe jashtë-kurrikulare, përfshirjen e tyre në takime ndërkombëtare, lidhjen me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë që siguron mundësi punësimi për të diplomuarit, lidhjet me universitete të huaja perëndimore, etj që, sigurisht, kanë impakt edhe në përmirësimin e cilësisë së përmbajtjes së programit. Ndërkaq, është realizuar në departament edhe një proces rishikimi i kurrikulave dhe janë bërë ndryshime të nevojshme kurrikulare në masë deri më 20%, të miratuara nga Senati Akademik i institucionit.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi praktikën e studentëve, me rëndësi në punësimin e ardhshëm, GVJ rezulton rigorozitet nga ana e departamentit në hartimin e tij e realizimin në forma të larmishme e sipas të gjitha procedurave.

Sidoqoftë, GVJ është i mendimit se, nëse deri tani praktikat dhe mundësitë e punësimit kanë qënë kryesisht tek KOASH dhe Fondacioni “Frymë Dashurie”, departamenti duhet të punojë më shumë për promovimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit e partneritetit në tregun e punës sepse programi, për unicitetin, objektivat e misionin që ka, presupozon për të diplomuarit e tij mundësi shumë më të gjëra punësimi. Nga ana tjetër, kjo do të rriste edhe impaktin në cilësinë e përmbajtjes së programit, me konsultimet e propozimet që do të vinin nga aktorët e tregut.

[ref: Minutat e vizitës, Mendimi i Dekanit mbi programin e Studimit; Raport i takimit për praktikën; Procedura për ndryshimin e kurrikulës deri në masën 20%; Raport i takimit për praktikën me studentët; Marrëveshje me “Frymë Dashurie”; Marrëveshje me KOASH].

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i CV-ve e veprimtarisë kërkimore - shkencore e botuese të personelit akademik, i angazhuar në realizimin e programit “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze”, rezulton se, si personeli akademik me kohë të plotë, ashtu edhe ai me kohë të pjesshme, i

	<p>përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Departamenti ka angazhuar në mësimdhënie personel të kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore, profesorë me përvojë akademike, duke aplikuar edhe modulet me lektorë të ftuar. Departamenti angazhon për programin 7 lektorë të përhershëm (1 me titullin “prof”, 4 Dr/PhD dhe dy asistentë-lektorë me kualifikimin përkatës), 5 profesorë vizitorë (2 me titullin “prof i asoc” dhe 2 Dr/PhD) 5 asistentë-lektorë me kohë të pjesshme. Gjithashtu, stafi, përgjatë zhvillimit të programit, ka vazhduar të jetë i angazhuar në projekte kërkimore-shkencore e veprimtari botuese në ndihmë të zhvillimit e rritjes së cilësisë së programit. Ngarkesa mësimore vjetore e stafit akademik aprovohet nga Senati, sipas kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>[ref: Raporti periodik analitik 2020-2021; Mendimi i Dekanit, Programi në Teologji Sociale dhe Shkenca Religjose; Studimet Shkencore nga Departamenti i Teologjisë; Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik për Programin].</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV-ve dhe dokumentacionit mbi kualifikimet dhe veprimtarinë kërkimore - shkencore e botuese të personelit akademik, me kohë të plotë e të pjesshme të programit “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjose”, rezulton se, në tërësi, ky program realizohet nga një staf pedagogjik me përvojë dhe i kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore, profesorë me përvojë akademike, me rol në jetën publike e fetare, brenda dhe jashtë vendit. Konkretisht, përgjatë vitit 2018-2019 në këtë program studimi janë angazhuar 5 lektorë me kohë të plotë (1 prof, 2 Dr/PhD, 2 Msc) dhe 8 pedagogë me kontratë (1 Dr/PhD, 1 Dr/PhD proces, 6 Msc). Në vitin 2019-2020 u angazhuan 7 personel akademik me kohë të plotë (1 prof, 3 Dr/PhD, 1 asistent në proces doktorature dhe 2 Msc) dhe 15 me kohë të pjesëshme (1 Prof.Asoc, 5 Dr/PhD, 1 asistent në proces doktorature dhe 8 asistente Msc). Në vitin 2020-2021 u angazhuan 7 personel akademik me kohë të plotë (1 prof, 4 Dr/PhD, 1 asistent në proces doktorature dhe 1 asistente Msc) dhe 16 me kohë të pjesëshme (3 Prof.Asoc, 4 Dr/PhD, 2 asistent në proces doktorature dhe 7 asistente Msc)</p> <p>Sipas raportit analitik 2020-2021, “personeli akademik ka një angazhim të vazhdueshëm në kërkimin shkencor, në konferenca ndërkombëtare, në përgatitjen e materialeve mësimore qoftë në forma tradicionale (libra, dispensa, separate etj.) dhe libra elektronike, që botohen nga Shtëpia Botuese e Kolegjit Universitar LOGOS”.</p> <p>[ref: Raporti periodik analitik 2020-2021; CV-të e stafit; Të dhëna për kualifikimin e stafit; Cilësia e stafit mësimdhënës; Të dhënat për personelin akademik në programin e studimit; Numri i personelit akademik në njësinë kryesore dhe përgjegjëse; Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe përgjegjëse].</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e CV-ve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, GVJ konstaton se diploma, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike, përvoja e niveli i kualifikimit, veprimtaria shkencore si dhe botuese e mëparshme dhe përgjatë zhvillimit të programit, janë në përputhje me natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Përveç personelit të kualifikuar me kohë të plotë, departamenti ka aktivizuar për programin pesë profesorë vizitorë, pesë lektorë me kohë të</p>

	<p>pjesshme dhe lektorë të departamenteve të tjera (specialistë për lëndën e Gjuhës Greke, Gjuhës Angleze, Informatikës, Shkrimin Akademik dhe Pedagogjisë), ndërsa synohet që bashkëpunimi me departamentet homologe jashtë vendit të forcohet dhe “të vazhdohet të ftohen profesorë nga universitete të tjera për kurse specifike”.</p> <p>[ref: CV- e stafit; Syllabusët e lëndëve; Studime Shkencore 2019, 2020, 2021; Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet me përgjegjësën e departamentit, stafin akademik e studentët e regjistruar në programin Bachelor në “Teologji Sociale e Shkenca Religjose” si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se për orientimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në zhvillimin e praktikës profesionale, punimit të diplomës etj, është caktuar një staf i duhur akademik, me kualifikimin përkatës.</p> <p>Departamenti ka hartuar dokumentacion përkatës që rregullon dhe kriteret e realizimit të këtyre veprimtarive. “Punimet e diplomës dhe specialistët që udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga Departamenti, duke bashkëpunuar edhe me qendrat kërkimore shkencore të Kolegjit Universitar “Logos” si edhe me institucione të tjera publike apo private që punojnë në fushat përkatëse” Udhëheqësi i punimit të diplomës, në bashkëpunim me studentin, përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij, grafikun e konsultimeve, etj. Departamenti përcakton edhe oponentët e punimit të diplomës. Lidhur me praktikën profesionale, ato zhvillohen në institucionet e caktuara nga dekanati (për programin, tek Fondacioni “Frymë Dashurie dhe tek insitucionet e KOASH), me të cilat është nënshkruar fillimisht marrëveshja e bashkëpunimit, nën drejtimin e pedagogut mbikëqyrës të caktuar nga fakulteti. Praktikën profesionale vlerësohen me kredite, njëllon si detyrimet e tjera dhe studenti duhet të respektojë rregullat e institucionit ku kryhet praktika profesionale. Edhe pedagogu përgjegjës, edhe studentët, kanë detyrime përkatëse të përcaktuara me rregullore, ndërsa institucioni pritës i përcjell departamentit vlerësimet për çdo student, të cilat konvertohen në notë nga pedagogu përgjegjës. Drejtuesi i praktikës profesionale në institucion dhe pedagogu përgjegjës dorëzojnë në departament një relacion shpjegues për punën e studentit gjatë zhvillimit të praktikës, ndërsa studenti ka të detyrueshme të dorëzojë në fund të saj një relacion shpjegues mbi përfitimet individuale prej saj.</p> <p>Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, me programin e praktikës, synon t’u sigurojë studentëve përvojë pune dhe t’i sjellë ata në kontakt me vendet e mundshme të punës.</p> <p>[ref: Minutat e Vizitës; Rregullore e Departamentit, Rregullore e diplomimit e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës; Syllabus i praktikës mësimore; Marrëveshje me KOASH dhe Fondacionin “Frymë Dashurie”].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentacionin përkatës si dhe nga vizita e GVJ në mjediset e institucionit, rezulton se, në në shërbim të veprimtarisë mësimore e kërkimore- shkencore si dhe në mbështetje të realizimit të programit “Bachelor” në “Teologji Sociale e Shkenca Religjose”, KU “Logos” ka një infrastrukturë efektive në të dy kampuset, si atelie për</p>

<p>mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>pedagogjinë, laborator të gjuhës greke, laboratorë të informatikës etj sipas përmbajtjes së programeve që ofron. Gjithashtu funksionojnë edhe dy biblioteka me fondin e tyre të materialeve të printuara dhe digjitale. Auditorët janë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme materiale dhe teknike (kompjuterë elektronikë, projektorë, etj) si dhe ka mjedise të posacme për realizimin e praktikës profesionale, gjithashtu me laboratorët e kompjuterave në dispozicion të studentëve. Kurrikula e programit përfshin lëndën e Informatikës për dy semestra dhe të gjuhëve të huaja për pesë semestra, të cilat zhvillohen në laboratorët përkatës, me lektorë të specializuar. Ndonëse në organikën e departamentit nuk ka personel ndihmës mësimor shkencor për laboratore dhe IT, ndërsa Biblioteka ka stafin përkatës të specializuar, në tërësi, Institucioni ka siguruar dukshëm mirëmbajtjen e këtyre mjediseve mësimore e të infrastrukturës në dispozicion të programit. [ref: Infrastruktura FSHHKGJ; Relacion mbi infrastrukturën, Mjediset e Fakultetit, Infrastruktura në Kampusi 2; RVB].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e institucionit, të njësisë përgjegjëse dhe asaj bazë që ofron programin në shqyrtim, GVJ konstaton se që në Planin Strategjik të KU “Logos” 2018-2024 përcaktohet si prioritet strategjik t’u jepet studentëve “një përvojë arsimore që u ofron atyre mundësinë për të përmbushur potencialin e tyre si individë duke u zhvilluar...si studentë të pavarur, të përgatitur për të marrë përgjegjësinë për zhvillimin e tyre personal dhe profesional gjatë gjithë jetës...”. Institucioni ka në vëmendje si objektivi standardin e lartë “në sigurimin e përvojave të suksesshme mësimore përmes zhvillimit të kurrikulimit, iniciativa të reja të mësimdhënies, kontribute dhe kritika konstruktive të bëra nga studentët, si dhe vëmendje e kujdesshme e stafit për mënyrën se si kurset dhe programet janë hartuar, zhvilluar dhe rishikuar”. Nga biseda me Dekanin e përgjegjës të departamentit të Teologjisë e Kulturës, që ofron programin e ciklit të parë në “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze”, rezultoi se janë përgatitur e shpërndarë për studentët udhëzues e materiale orientuese për zhvillimin e përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies, në përputhje me fushat përkatëse të studimeve, sipas parametrave bashkëkohore. Në praktikën e institucionit ka tashmë përvojë në organizimin e trajnimeve të personelit akademik për kualifikim të mëtejshëm në metodat e mësimdhënies, por edhe impakt në këtë drejtim nga trajnimet që lidhen me publikimet shkencore si dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore. Janë zhvilluar trainime për njohjen e inovacioneve në përdorimit e teknologjisë për zhvillimin e mësimin në klasë dhe, në kushtet e pandemisë Covid-19, për mësimin në distancë. Departamenti ka aplikuar shfaqjen e një sërë videosh, të serisë Educational Tips, me udhëzime për çështje praktike që rrisin cilësinë dhe efikasitetin e mësimdhënies dhe procesit të të nxënies nga ana e studentëve, si e-learning e vecanërisht NEO LMS platform, si të bëhet mësim online me Webex, Zoom and Skype, mbi Microsoft Teams and Google Meet dhe si të kombinohen ato me NEO LMS Platform, si të përdoren Prezi and Prezi Video për kurset online dhe për krijimin e videove edukative. Në dispozicion të stafit janë venë udhëzues, si: “Manual përdorimi për softëare Edupage”, “Udhëzues për Microsoft 365” për stafin dhe studentët, etj. Objektivi i përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies është venë në fokus edhe të partneritetit me universitete jashtë, si psh me atë “Democritus” Thrakë, për seminare didaktike shkencore të kësaj natyre. (teknikat e të nxënies, mbështetje e profesoratit për shkëmbimin e praktikave më të mira, moderne dhe efektive në përdorimin e TIK-ut në mësimdhënien e lëndëve universitare, etj).</p> <p>[ref: Minutat e Vizitës; RVB; Udhëzues mësimi në distancë; Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit; Trainim për</p>



	platformën Mic Office 356; Propozim për trajnim për zhvillimin e fakultetit].
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në Planin strategjik të KU “Logos” 2018-2024, përcaktohet se “...pasaporta e një universiteti modern për njohjen sociale dhe dallimin ndërkombëtar është përsosmëria akademike. Kjo mund të arrihet vetëm nëse të gjitha pjesët përbërëse, p.sh. stafi akademik dhe administrativ, punojnë shumë brenda një strukture të shëndoshë organizative. Mjeti kryesor për të siguruar këtë është një sistem i brendshëm i përhershëm i sigurimit të cilësisë bazuar në standardet kombëtare dhe ndërkombëtare”.</p> <p>Në institucion dhe në njësitë përgjegjëse dhe bazë funksionojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të procesit mësimor e performancës së personalit akademik dhe ndihmësakademik. Përcaktuar me statut, e sipas Rregullores së Sigurimit të Cilësisë, në rang institucioni funksionon Komisioni Sigurimit të Cilësisë (KSC) për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë me 3 anëtarë nga stafi akademik, një përfaqësues të Senatit dhe 1 student të rekomanduar nga Këshilli Studentor. Tjetër strukturë e monitorimit dhe vlerësimit është edhe NJSBC që, si formë të veprimtarisë së saj, ka vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, organizimin, në fund të cdo semestri apo para fillimit të sezonit të provimeve, të pyetësorët me studentët për cilësinë e mësim dhënies në cdo lëndë të programeve të studimit., realizimin e “studimeve gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara”.</p> <p>NJSBC evidenton përmbushjen e detyrave me hartimin e raporteve të vlerësimeve për çdo program studimi, të cilat shërbejnë si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si dhe për vlerësimin e jashtëm. Në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë të institucionit, përcaktohen burimet dhe instrumentat e vlerësimit të brendshëm, si: dokumentet ligjorë e rregullatore, të dhënat nga sistemet e informacionit në institucion, vlerësimet e drejtuesve, ekspertëve, kolegëve, të diplomuarve, bashkëpunorëve, punëdhënësve, të dhënat e mbledhura nga anketimet, nga plotësimi i formularëve të vlerësimit, intervistave, fokus grupeve, vëzhgimit, rezultateve të provimeve e diplomimit.</p> <p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar i veprimtarisë së njësisë përgjegjëse dhe asaj bazë që ofron programin, evidentohen format e punës për kontrollin e cilësisë së brendshme, ku i kushtohet rëndësi edhe analizës së vlerësimit të studentëve për stafin akademik (formulari është i zberthyer në indikatorë të detajuar, që mundësojnë një proces vlerësimi për një sërë komponentë të përmbajtjes e organizimit të mësim, të pedagogjisë e komunikimit me studentët), analizës së formularëve të vetëvlerësimit të stafit, si dhe promovimit të praktikave e shëmbujve të mirë të performancës së stafit akademik.</p> <p>[ref: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë; Statuti i KU “Logos”; Rregullore e FSHHKGJ; Politika për Sigurimin e Cilësisë; Vendime mbi përbërjen e NJSBC; Paketa e Instrumenteve të NJSBC; Proces verbali i takimit No 4].</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në Planin Strategjik 2018-2024 të institucionit theksohet se sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë realizohet nëpërmjet “një bashkëveprimi harmonik me trupën e studentëve dhe një ndjenjë të fortë pronësie mbi reformat radikale të përfshira nga të gjithë aktorët kryesorë” Në të është përcaktuar, si objektivi themelor, vendosja e studentëve “në zemër të universitetit”, për t’i bërë ata “partnerë aktivë në edukimin e tyre”. Nga shqyrtimi në përgjithësi i dokumentacionit përkatës dhe bisedat me studentët në institucion, GVJ evidenton përpjekjet për krijimin dhe funksionimin e parimeve që shërbejnë si bazë për punën e partneritetit ndërmjet studentëve dhe stafit, duke realizuar përfshirjen e studentëve në marrjen e vendimeve në lidhje me politikat dhe praktikën e mësimdhënies dhe të nxënies, aplikimin e feedback-ut të studentëve për përvojën e tyre arsimore, por edhe reagimin nga ana institucionale të vërejtjeve e sugjerimeve të tyre.</p> <p>Në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë të KU “Logos”, përcaktohet e drejta e studentëve për të shprehur vlerësimin e tyre lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit të institucionit. Këshilli studentor shpreh mendime dhe propozime për problemet më të rëndësishme të institucionit, për planet e programet mësimore, rregulloret mbi veprimtarinë mësimore, cilësinë e shërbimeve që ofron institucioni. Studentët marrin pjesë në KSC-në në nivel institucioni dhe në GVB-të në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Sigurimi i cilësisë si proces garanton pjesëmarrjen e studentëve edhe nëpërmjet plotësimit prej tyre të formularëve, pyetësorëve, pjesëmarrjes në intervista dhe fokus grupe.</p> <p>Në departamentin e Teologjisë dhe të Kulturës janë të dokumentuara edhe ankimet e studentëve lidhur me probleme të mbarëvajtjes e cilësisë së procesit mësimor apo të vlerësimit si dhe përgjigjet përkatëse e marrjen e masave nga ana e departamentit. Departamenti ka të përcaktuara në rregullore rastet e ankimit të studentëve dhe procedurat e zgjidhjes së tyre</p> <p>[ref: rregullore e Sigurimit të Cilësisë; Politika për Sigurimin e Cilësisë; Proces-Verbal Takimi I KPSSC 4.04.2021; Raport nga NJSBC për rezultatet; Grupet e vlerësimit nga kolegët; Zhvillim pyetësore mbi syllabuset; Mbi pyetësorët e provimeve; Vendim i komisioni të Provimeve-kërkesa e studentit për rishqyrtim; Rregullore e Këshillit Studentor; Vlerësime të kryera nga NJSBC; Pyetësorët e vlerësimit nga Departamenti; Rregullore e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës].</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit përkatës, RVB dhe nga biseda me përfaqësues të NJSBC, konfirmohet se është në praktikën e punës së institucionit, njësisë përgjegjëse dhe asaj bazë që rezultatet e procesit të vlerësimit, pasi përpunohen nga struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, u komunikohen autoriteteve drejtuese të institucionit, posaçërisht përgjegjësit të departamentit, i cili ia bën të ditur personelit akademik. Në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë përcaktohet se informacioni mbi rezultatet e procesit të vlerësimit që bëhet publik është “i përshtatshëm për qëllimin që ka, i arritshëm, i besueshëm dhe përcillet me një gjuhë të kuptueshme për të gjithë”. Ai monitorohet nga NJSBC-ja dhe “përditësohet rregullisht”.</p>

	<p>Departamenti i publikon rezultatet e vlerësimit cdo vit, në raportin vjetor zyrtar, që mund të shkarkohet dhe lexohet në faqen e internetit të Departamentit: https://theolkulogosalb.ëordpress.com. [ref: Minutat e Vizitës; Reagimet e studentëve të Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës mbi RVB; Raport nga NJSEC për rezultatet; Internal Quality Assurance Unit Report; Rregullore e Sigurimit të Cilësisë].</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në takimet në institucion si dhe nga dokumentacioni, GVJ vëren se, ndërsa është krijuar një proces institucional vlerësimi për performancën e departamentit e stafit akademik, kjo, nga ana tjetër konsiderohet si procedurë që ndihmon për të kuptuar edhe shkallën e nevojave dhe përmirësimeve në këtë proces Në mbledhjen e departamentit diskutohen rezultatet e vlerësimit, ndërsa paraprkasht drejtuesi u komunikon anëtarëve të stafit, në rrugë personale, të dhënat nga vlerësimi i performancës së tyre në mësimdhënie, mbështetur tek pyetësorët e kryer. Bazuar në procesin e vlerësimit, departamenti promovon shembuj të praktikave të mira, si dhe nxit e inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. [Ref: Minutat e Vizitës; RVB; Analizë Vjetore e Departamentit].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, planeve mësimore dhe syllabuseve të lëndëve, rezultojn se institucioni e ka ndërtuar procedurën e format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të dijeve, në përputhje të plotë me rregulloren në fuqi (VKM Nr.531, datë 24.01.2018). Procesi mësimor është i organizuar me leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, praktika profesionale, teste, provime semestrale dhe mbrojtje e diplomës/ provim i përgjithshëm përfundimtar. Aplikohen gjithashtu format e leksioneve me lektorë të ftuar, leksione të hapura, workshop-e, seminare dhe konferenca shkencore. [ref: Rregullore e programit të studimit, Planet mësimore; Syllabuset e lëndëve].</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Sipas bisedës me përgjegjësën e njësisë bazë, stafin akademik të angazhuar në programin e studimit dhe studentët të programit, evidentohet se personeli bën përpjekje t'u përgjigjet nevojave dhe diversitetit të studentëve si dhe sugjerimeve të tyre lidhur me programin e mësimdhënien. Studentët e programit "Bachelor" në "Teologji Sociale dhe Shkencat Religjose" vijnë nga mjedisë shoqërore e kulturore të ndryshme, edhe nga vende fqinjë, me pritshmëri të larta, ndaj stafi mësimor është përpjekur të realizojë, në mënyrë profesionale, detyrimin</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>dhe me forma, metoda, aktivitete formuese e mundësi alternative mësimdhënieje t'u përgjigjet interesave e këndvështrimeve si dhe aspiratave të auditorit. Në raste specifike, psh të problemeve me gjuhën, për një student nga Maqedonia e Veriut, u siguria mbështetja e tij me tutoriat në disa lëndë.</p> <p>Në larminë e metodave e formave të mësimdhënies, përdorimi i teknologjisë dixhitale, si në auditor, ashtu edhe në mësimin në distancë për shkak të pandemisë, ka zenë vend qëndror.[ref: Minutat e Vizitës, RVB].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni realizon forma të ndryshme në mbështetje të personelit akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike e përdorimin e metodave të reja pedagogjike. Sipas RVB, janë hartuar e vënë në përdorim udhëzues të posacëm për aplikimin e metodave didaktive e innovative; në përgjigje të situatës së pandemisë e zhvillimit të mësimin online, personeli akademik është pajisur “me një dokumentacion të plotë për mësimet online dhe vlerësimin e studentëve”</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të institucionit në këtë fushë, rezultojnë se pedagogët trajnohen në mënyrë periodike, në përputhje me kualifikimin e tyre pedagogjik e shkencor. “Educational Tips”- një seri web-i me disa seanca tematike udhëzuese për mësimin në distancë, trajnimi për platformën “Microsoft Office 365”, manuali Edupage etj, kanë patur synim të drejtpërdrejtë përgatitjen e stafit për metodologjinë e mësimdhënies në kushtet e pandemisë. NJSBC ka hartuar edhe formularin për të vlerësuar cilësinë e përdorimit të platformës dixhitale në mësimin në distancë.</p> <p>Gjithashtu, rezultojnë se edhe në projektet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere, është synuar shkëmbimi i eksperiencës dhe njohjeve të reja në fushën e metodologjisë e kompetencave didaktike. [ref: Pyetësor për pedagogët për platformat dixhitale; Njoftimet për trajnimet e platformës dixhitale; Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit; Udhëzues mësimi në distancë; Manual Edupage-pedagogët, RVB].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga biseda e GVJ me stafin akademik e studente të programit si edhe nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik dhe angazhimet te tyre përkatës në lëndët e programit të studimit, rezultojnë se titullarët e lëndëve kanë një background të pasur akademik dhe shkencor në fushat e tyre të studimit dhe mësimdhënies, eksperiencë profesionale në metodologjitë e didaktikën mësimore. Vec stafit vendas, pjesë e trupës pedagogjike me kohë të plotë dhe të pjesshme janë edhe profesorë të disiplinave që përmban programi nga universitete jashtë vendit, me një CV të pasur dhe ekspertizë shumëvjeçare. Studentët e ciklit “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze” shprehën, në takimin me GVJ, konsiderata pozitive për mënyrat dhe kompetencat në mësimdhënie e mësimnxënie të stafit akademik që mbulon programin.</p> <p>[ref: Minutat e Vizitës; CV-te e personelit akademik; Syllabuset e lëndëve].</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në</p>	<p>Nga takimi i GVJ me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik dhe grupin e studentëve të programit, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezultojnë kujdesi e përpjekja nga ana e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>institucionit për të përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë edhe mendimet e sugjerimet e studentëve. Procesi i realizimit të vlerësimit të brendshëm, formë e të cilit janë edhe plotësimi i pyetësorëve nga ana e studentëve, ndihmon në analizën, reflektimin dhe përmirësimin nga ana e stafit pedagogjik të cilësisë së mësimdhënies, të didaktikës e metodologjisë së përdorur, literaturës etj, të lidhur me programin. Në raportin e NJSBC i datës 22.07.2019, mbi vlerësimin e pyetësorëve të studentëve mbi departamentet, evidentohet se, në plotësimin e pyetësorëve mbi cilësinë e programit “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjose”, “u vu re një pjesmarrje e plotë e studentëve” dhe “vlerësimet individuale të secilës pyetje kanë qënë maksimale”. Në këtë dokument evidentohet gjithashtu edhe sugjerimi i studentëve “për të qënë pjesë më aktive në përmirësimin e programit dhe dhënien e mendimeve për literaturën e përdorur...”. Sipas dokumentit, “...lidhur me vlerësimin e stafit, studentët janë përgjithësisht të kënaqur me cilësinë e procesit mësimor”.</p> <p>Lidhur me këto vlerësime, departamenti reagon institucionalisht, duke i bërë kërkesat e përmirësimit të formave e metodave të mësimdhënies objekt edhe të seminareve didaktike, brenda e jashtë vendit.</p> <p>[ref: Minutat e Vizitës; Programi i trajnimit për metodat e mësimdhënies; Raport nga NJSBC për rezultatet].</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga biseda me stafin akademik dhe studentë të programit, evidentohet përpjekja për të përdorur metoda interaktive dhe diskutimi që i bëjnë interesante e efektive orët e mësimit.</p> <p>Programi në “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjose” është i lidhur me analizën e një realiteti dinamik të kulturave fetare e rolit të tyre në zhvillimin historik të shoqërisë e qytetërimeve si dhe me një impakt të drejtpërdrejtë në realitetin shqiptar, cka sjell interes e një mjedis interaktiv diskutimi. Pajisja e klasave me teknologjinë dixhitale, përdorimi i kompjuterave, laptopeve e tabletave, shfrytëzimi i projektorëve gjatë zhvillimit të lëndëve, krijojnë një mjedis mësimdhënieje e mësimnxënieje interaktiv dhe efikas. Aplikimi i platformës e-learning ka krijuar mundësinë për shkëmbim informacioni, zhvillimin e detyrave e testeve online etj.</p> <p>[ref: Minutat e Vizitës; RVB; Students-Guide NEO-LMS; Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga biseda me stafin pedagogjik dhe studentët e programit “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjose”, rezulton se ekziston, në marrëdhëniet pedagog-student, një frymë e mirë etike e njerëzore komunikimi si dhe bashkëpunimi në fushën e mësimdhënies. Studentët pohuan përpjekjen nga ana e stafit për të inkurajuar tek ata sensin e autonomisë e diskutimin e lirë, marrëdhënie bashkëpunimi frytdhënëse e komunikim etik.</p> <p>Studentët inkurajohen të zgjedhin temat e detyrave të kursit apo projekteve, ndërsa aktivitetet kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, organizimi i shkollave verore, seminareve e workshop-eve me tema të përditësuara, botimi i një reviste të posacme shkencore studentore, hapësirat dhe roli në procesin e vlerësimit të brendshëm, apo koha e lirë, mbi 50% për studim të pavarur, - janë forma të larmishme që ndihmojnë në aftësimin e tyre të mëtejshëm për mendim të pavarur e kritik.</p>

	[ref: Minutat e Vizitës; Raport periodik analitik i departamentit 2018-2019,2019-2020, 2020-2021; Revista studentore “Fjala”].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga takimet e vizita në institucion, GVJ konfirmon se institucioni ka siguruar hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të pastra e të mirëmbajtura për zhvillimin e procesit mësimor e shkencor. Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës është vendosur në një kampus, në një kompleks modern ndërtesash rreth Manastirit të Shenjtë të Shën Vlashit ku infrastruktura u përgjigjet kërkesave e standarteve të cilësisë, pastërtisë dhe mirëmbajtjes. Kampusi ka mjedise të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor (raporti i sipërfaqes së mjediseve mësimdhënëse me numrin e studentëve është 4.8 m ² për student) dhe aktiviteteve të tjera kurrikulare dhe ekstrakurrikulare. [ref: Minutat e Vizitës; Raport periodik analitik i departamentit 2018-2019,2019-2020, 2020-2021].
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Nga takimet e vizita në institucion, GVJ konfirmon se mjediset që i dedikohen procesit mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme. Ekziston një lidhje e qëndrueshme Wi-Fi, që shfrytëzohet brenda klasave gjatë mësimin dhe që ndihmon zhvillimin interaktiv dhe atë në distancë të tij, por edhe në cilësinë e mësimdhënies. Departamenti ka blerë projektorë dhe laptopë të rinj, që e kanë rritur cilësinë e mësimin dhe kanë krijuar një mjedis digjital dhe interaktiv brenda klasës, duke u dhënë mundësi lektorëve dhe auditorit të përdorin PowerPoint, Harta Digjitale, Video/Dokumentarë, materiale nga platforma dixhitale e departamentit. Ka tabela dhe, në shumicën e klasave, projektorë. Nga ana e Departamentit, ka propozime për përmirësime të mëtejshme të mjediseve me tabela të bardha fikse ose “flipping” dhe një ekran fiks projektori apo për tryeza të rrumbullakëta për disa klasa, për të forcuar më tej cilësinë e procesit mësimor e komunikimin me studentët. [ref: Minutat e Vizitës; Raport periodik analitik i departamentit 2020-2021].
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Në kampusin e Shën Vlashit, ku është vendosur departamenti i Teologjisë dhe Kulturës dhe zhvillohet programi “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze”, mjediset ku bëhet mësimi janë të pajisura me kompjutera portativë, projektorë dhe lidhje interneti, duke u dhënë mundësi personelit akademik dhe studentëve ta shfrytëzojnë këtë infrastrukturë për realizimin e një procesi interaktiv mësimdhënies e mësimnxënies. Në kampus funksionon edhe laborator i posaçëm i informatikës, ndërsa biblioteka ka 6 poste për përdorim kompjuteri.

	[ref: Minutat e Vizitës; Infrastruktura në Kampusin 2; Raport periodik analitik i departamentit 2020-2021;
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	<p>Nga vizita në institucion, takimi me stafin pedagogjik dhe studentët e programit si dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se literatura bazë dhe ajo e rekomanduar (fizike dhe digjitale) për disiplinat në përmbajtje të programit të studimit, është e aksesueshme për studentët në shqip, greqisht, anglisht dhe gjuhë të tjera, për të garantuar marrjen e dijeve dhe informacionit të nevojshëm. Si procedurë, tekstet mësimore, me propozim të titullarëve të lëndëve, miratohen nga departamenti e u bëhen të njohura studentëve me fillimin e vitit akademik.</p> <p>Cdo kurs ka literaturën e vet specifike, bazë dhe ndihmëse. që studentët e marrin në kohë, në formë fizike dhe elektronike. Gjithashtu materiali është i ngarkuar në hapësirën përkatëse në platformën e-learning, ndërsa biblioteka ofron një gamë të gjërë materialesh të fushave të programit.</p> <p>[ref: Minutat e Vizitës; syllabuset e lëndëve; Raport periodik analitik i departamentit 2020-2021].</p>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	<p>Nga vizita në Bibliotekën e institucionit e biseda me personelin, si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës, rezulton se ajo disponon një numër botimesh, klasike dhe të reja, edhe të viteve të fundit, për fushat kryesore të programit, dhe është në pasurim e sipër me tituj të rinj.</p> <p>Aktualisht Biblioteka e KU “Logos” numëron mbi 22800 libra, 19912 tituj, 647 Fjalorë dhe Enciklopedi, 180 tituj Periodikësh, Materiale jo libra CD, DVD 478 njësi etj.</p> <p>Biblioteka e kampusit në Shën Vlash disponon mbi 18.000 tituj (libra, enciklopedi, revista, burime, etj.) në funksion të programit të studimit “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze”. Në tre vitet e fundit të funksionimit të programit, kanë hyrë gjithsej 507 libra, tituj të rinj. Ajo është një bibliotekë me hapësirë komode dhe infrastrukturën e nevojshme në shërbim të studentëve dhe stafit akademik</p> <p>[ref: Minutat e Vizitës; Raport periodik analitik i Departamentit].</p>
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	<p>Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, me vendim Departamenti, studentët e programit trajnohen që në fillim të vitit akademik, duke marrë pjesë në një seminar të detyrueshëm për përdorimin e bibliotekës dhe burimeve dixhitale nga personeli i specializuar i departamentit. Pas përfundimit të një seminari trajnues 30-orësh, studentët marrin një certifikate që i konsideron ata “të përgatitur për kërkimin e tyre shkencor për çdo fushë të studimeve të tyre në Teologji”. Certifikata është parakusht për diplomimin. e tyre. Studentët kualifikohen të jenë në gjëndje të kërkojnë dhe hartojnë bibliografinë, të menaxhojnë dhe përdorin burimet (dixhitale dhe të printuara) për studime teologjike, të njohin stadet dhe organizimin e kërkimit shkencor, të punojnë në mënyrë metodike për të përgatitur temën shkencore, të përdorin platformën e të nxënit elektronik. Njohja e përdorimit të Sistemit OPAC, informacioni mbi “Dijet informacionale nga Teknologjitë e reja dhe Komunikimi”, mbi sistemet e citimit, indeksimit e arkivimit, mbi përdorimin e platformës të të nxënit elektronik “Neo LMS”, etj, bëjnë që studentët të jenë të aftë të aksesojnë e shfrytëzojnë burimet online të Bibliotekës në dispozicion të tyre, që lidhen me programin përkatës.</p>

	[ref: Vendim I Departamentit të Teologjisë për Përdoruesit e Bibliotekës; Raport i Përfundimit të trajnimit për bibliotekën; Certifikatë për trajnimin në Bibliotekë].
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga stu që përdoren gjerësisht në botë për studimet teologjikedentët.</p>	<p>Rezulton se, për vetë profilin e programit të studimit të ciklit të parë në “Teologji Sociale dhe Shkenca Religjoze”, lind nevoja e shfrytëzimit të vazhdueshëm të Bibliotekës së institucionit nga ana e studentëve, për realizimin e detyrave të kursit, punimeve të diplomës, seminareve apo aktiviteteve të tjera kurrikulare dhe ekstrakurrikulare.</p> <p>Biblioteka në kampusin kryesor në Tiranë, me sipërfaqe 186 m² si dhe 4 nyje sanitare, është ndërtuar me standarde të larta. Ka 18 poste me akses kompjuteri dhe 40 poste të tjera studimi. Përveç kësaj, një bibliotekë e dytë, por jo më pak e rëndësishme, ndodhet në kampusin Shën Vlash, Durrës, me sipërfaqe 118 m². Ajo ka dhe dy salla periodiku me sipërfaqe respektivisht 8m² dhe 12 m², 6 poste me akses kompjuteri dhe 20 poste të tjera studimi. Cdo kompjuter ka programet themelore për kërkime teologjike si Diogjeni, TLG dhe BibleWorks. Biblioteka e kampusit ka orar të zgjatur, për t’i ardhur sa më shumë në ndihmë studentëve (8.00-23.00) Materialet që përfshin Biblioteka e KU “Logos” janë të printuara ose elektronike dhe i përkasin disiplinave të ndryshme, si ekonomi, mjekësi, teologji, filozofi, shkenca humane e sociale, teknologji informacioni etj. Aktualisht ajo numëron mbi 22800 libra, 19912 tituj, 647 Fjalorë dhe Enciklopedi, 180 tituj Periodikësh, Materiale jo libra CD, DVD etj. 478 njësi. Katalogu elektronik http://lib-orthodoxalbania.org ndihmon cilindo në gjetjen e informacionit që disponon fondi i bibliotekës.</p> <p>KU “Logos” ofron akses në literaturën online të bibliotekës ndërkombëtare Questia Online Library: www.questia.com. Gjithashtu institucioni, në bashkëpunim me Universitetin e Pireut ofron akses në literaturën online të bibliotekës së këtij Universiteti: http://digilib.lib.unipi.gr/ket/ dhe është në procesin e finalizimit të një marrëveshjeje me Universitetin “Aristotel” të Selanikut, për përdorimin e bibliotekës së tij të pasur digjitale online.</p> <p>[ref: Minutat e Vizitës; Relacion mbi Infrastrukturrën; Infrastruktura FSHHKGJ; Orari I Bibliotekës; Biblioteka “Ngjallja”].</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës e biseda me personelin akademik e studentët, konstatohet se në funksion të mësimdhënies, shfrytëzohet efektivisht platforma online (e-learning). (NEO-LMS https://theolkulogos.neolms.eu/), që krijon mundësinë e një komunikimi interaktiv. Departamenti zotëron e ka venë në dispozicion një dokumentacion të gjërë, me udhëzues e manuale të përdorimit të platformave dixhitale, si për studentët ashtu edhe për pedagogët. Zhvillimi i procesit mësimor gjatë pandemisë u mbështet dhe e vuri më shumë në efencë komunikimin online.</p> <p>Sipas RVB, institucioni, “në faqen e tij zyrtare: https://www.KolegjiUniversitarLogos.edu.al/al/logos-online.html, ka të përfshirë edhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit, që këtë vit kaloi në Platformën Microsoft Teams, duke mundësuar komunikimin e pedagogëve me studentët për cdo lëndë të programit akademik. Komunikimi realizohej përmes llogarive personale të cdo studenti.</p>

	[ref:RVB; Students-Guide NEO-LMS; Udhëzues Guide NEO-LMS për lektorët; Manuali Office 365 Teams për studentët; Manuali Office 365 Teams për lektorët].
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Sipas dokumentacionit përkatës dhe RVB, në institucion është krijuar mundësia e një sistemi funksional komunikimi të brendshëm për personelin akademik e studentët, për akses në dokumentacionin elektronik. Platforma digitaie e posacme e departamentit u jep mundësi pedagogëve të ngarkojnë materialet mësimore (leksione, prezantime, detyra të ndryshme) që janë të aksesueshme në kohë nga studentët; cdo anëtar i stafit akademik ka hapësirën vetjake të dedikuar, ku mund të ngarkojë lëksionet përkatëse dhe mënyrën e administrimit të saj përgjatë semestrit. Platforma e-learning ka krijuar mundësi komunikimi midis pedagogëve, departamentit, lektorëve dhe studentëve për njoftime të rëndësishme, ndërsa për nevoja administrative, dokumente etj, studentët përdorin platformën Edupage. Funksionon edhe llogaria Skype e departamentit, ndërsa sekretaria mësimore shfrytëzon për komunikim me studentët grupet Whatsapp. [ref: RVB; Manual Edupage-studentët; Manual Edupage-pedagogët].
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Nga biseda e GVJ me stafin akademik dhe studentë të programit, si dhe nga njohja në sekretarinë mësimore me tematikën e diplomave të studentëve që kanë përfunduar programin, rezulton se procesi i përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomave zbaton rregulloret e institucionit që, për këtë qëllim, ka një dokumentacion të gjerë e të qartë. Udhëheqja e temave bëhet në përputhje me orientimin nga ana e personelit akademik dhe sipas interesit të studentëve, në përshtatje me profilin përkatës. Studentët, për diplomimin e tyre, kanë si kusht, sipas rregullores, një mesatare nga 8.50 e lart deri në fund të vitit të dytë akademik (semestrin e 4-t) dhe të kenë kaluar me sukses të gjitha lëndët. Për studentët e kësaj kategorie, departamenti ka hartuar edhe një dokument zyrtar të posacëm që përshkruan dhe orienton të gjithë procesin. Studentët i paraqesin me shkrim Departamentit propozimet e tyre për temat që janë të interesuar, ku përfshihen titulli i tezës, përshkrim i shkurtër i temës, rëndësia dhe motivimi, metodologjia, fusha e përgjithëshme, etj dhe presin miratimin e profesorit mbikëqyrës që ata zgjedhin, i cili bashkëpunon me Mentorin Akademik të Departamentit. Mbikëqyrësi duhet të jetë zotëruar i një doktrature (PhD) dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ketë më shumë se pesë teza për të mbikëqyrur. Pas kësaj, departamenti duhet t'i shqyrtojë dhe t'i aprovojë të gjitha propozimet në një mbledhje zyrtare dhe të publikojë për profesorët vendimin për caktimin e mbikëqyrjes së studentëve. Udhëheqësi, në bashkëpunim me studentin, përgatit programin e punës, afatet e përafërta të realizimit të punimit, grafikun e konsultimeve i cili është i detyrueshëm. Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur diplomën, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi e miraton e plotëson fletën e vlerësimit, që lejon mbrojtjen e punimit duke e nënshkruar atë. Departamenti përcakton oponentët e punimit të diplomës dhe datën e dorëzimit të materialeve në departament. Organizimi i mbrojtjes së diplomës dhe vlerësimi i punimit bëhen sipas procedurës që parashikon rregullorja përkatëse.

	Ref: Minutat e Vizitës; Rregullore e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës; Rregullore e Diplomimit e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës; Rregullorja për tezën e diplomës dhe tabelën e vlerësimit; Rregullore e studimeve Teologji Sociale; Vendim Departamenti-Pranimi i temave].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Në KU “Logos” është funksionale Struktura e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, si strukturë që koordinon dhe bashkërendon aktivitetet midis njërive bazë dhe asaj kryesore në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Gjatë pandemisë së Covid 19, Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës ka përdorur teknologji inovative në klasë dhe në mësimin në distancë. Për këtë ka promovuar me anë të disa videove në internet, se si përdoren këto lloj teknikash për të përmirësuar mësimdhënien.</p> <p>Gjithashtu universiteti rezulton se ka botuar një udhëzues dhe rregullore informuese për mësimin në distancë, gjatë pandemisë, si dhe ka organizuar trajnimin e lektorëve për përmirësimin e aftësive të tyre mësimore.</p> <p>Për këtë Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, në bashkëpunim me Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, kanë shfrytëzuar dhe partneritetin ndërkombëtar për të zhvilluar një trajnim nga njësi e mbështetjes së mësimdhënies pranë Universitetit “Demokrit” në Trakë.</p> <p>[Ref. Udhëzues për mësimin në distancë; Urdhër për përdorimin e platformës digjitale për mësimin në distancë].</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar, si dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se në Rregulloren e Kolegjit Universitar “Logos”, parashikohet ngritja e grupeve mësimore të përhershme dhe/ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor. Aty, parashikohen edhe detyrat e këtyre grupeve, fusha e veprimtarisë, si edhe mënyra e funksionimit të tyre.</p> <p>Departamenti rezulton se ka marrë përgjegjësinë për cilësinë e mësimdhënies dhe për sigurimin e shërbimeve të nevojshme arsimore për studentët. Një ndër mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të aftësive mësimdhënëse të stafit akademik në program është plotësimi i “Pyetësorit të Vlerësimit të Cilësisë së Mësimdhënies së Lëndës” nga ana e studentëve në fund të çdo semestri, rezultatet e të cilit përpunohen nga NJBSC dhe së bashku me rekomandimet e njësisë analizohen dhe konsultohen më gjerë në departament. Gjatë semestrit ose në fund të tij, departamenti kryen një takim me studentët, për të diskutuar rreth</p>

	<p>problemeve, apo vështirësive, që mund të hasin në përvojën e mësimdhënies. Krahas kësaj, në bazë dhe raportit dhe evidencave përkatëse, rezulton se departamenti ka zhvilluar dhe orë të hapura pas mësimit për secilën lëndë, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>[Ref. Vendim për vlerësimin e brendshëm; Vendim për orët e bashëpunimit].</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm dhe evidencave të dorëzuara, rezulton se gjatë vitit 2020, janë shpërndarë manuale të mësimit online, si edhe janë zhvilluar trajnime të stafit lidhur me metodat e reja të mësimdhënies.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, departamenti zhvillon gjithashtu dhe një diskutim për këtë aspekt. Sipas raporteve të vetëvlerësimit dhe sugjerimeve, që merren për ato raporte, konkludohet mbi metodat e reja të mësimdhënies dhe risitë, që mund të punohet. Çdo pedagog është i lirë të kryejë metodën, që ai propozon ose dëshiron të provojë dhe ai/ajo monitoron progresin me ndihmën e këshillit të përhershëm të Departamentit.</p> <p>[Ref. Urdhër për përdorimin e platformës digjitale për mësimin në distancë].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në bazë të RVB, evidencave dhe intervistave të zhvilluara në IAL, rezulton se personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm, në përbërje të Departamentit, ka kryer kurse trajnimi, brenda dhe jashtë vendit, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kualifikimet dhe vlerësimet e tyre janë monitoruar përmes plotësimit të formularëve specifikë të vetëraportimit. Gjithashtu, në fund të çdo viti akademik KU “Logos” publikon dhe analizon raportin vjetor, në të cilin trajtohet veprimtaria kërkimore-shkencore gjatë një viti akademik.</p> <p><i>RVJ rekomandon se pavarësisht të qenurit departament i ri dhe kushteve të pandemisë, departamenti të shohin mundësitë e organizmit të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe t'i jipet një prioritet kërkimit shkencor në nivel njësie.</i></p> <p>[Ref. Raport vjetor 2018-2019, 2019-2020; Analizë vjetore e departamentit; Raport vjetor për veprimtarinë kërkimore shkencore të KU “Logos” për vitin akademik 2019-2020].</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>KU “Logos” nuk ka njësi përgjegjëse për trajnimin e personelit akademik, megjithatë në bazë të të dhënave rezulton se ka realizuar trajnime në bashkëpunim me universitete të huaja në lidhje me programet ERASMUS +.</p> <p>Referuar takimit në institucion me drejtuesit e Fakultetit, Departamentit si dhe stafin, rezulton që IAL nxit stafin akademik për pjesëmarrje në konferenca, workshope, si dhe botime të artikujve në revista shkencore nëpërmjet mbulimit të shpenzimeve financiare.</p> <p>[Ref. Propozim për një trajnim për zhvillimin e Fakultetit].</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e</p>	<p>Referuar takimeve të zhvilluara në institucion si me drejtuesit ashtu dhe me stafin, GVJ konkludon se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe</p>

mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. [Ref. Vendime të Departamentit: “Kampet Verore”; “Ndërto Karrierën tënde”; “Përdoruesit e bibliotekës”; “Mentori Akademik”; “Përgatitja e Seminareve jashtëkurrikulare”; “Trajnimi i Gjuhës Shqipe].			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Për shkak të kushteve të pandemisë gjatë tre semestrave të fundit, nuk ka patur eksperimentime në një shkallë të gjerë, por janë zhvilluar trajnime dhe udhëzime të veçanta në dispozicion të personelit akademik, si në nivel institucional, ashtu edhe në departament për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve, duke shërbyer në përmirësimin e cilësisë. Në bazë të RVB rezultojnë se, në fund të çdo viti akademik bëhet analiza në rang njësie bazë, më pas në rang njësie kryesore dhe në fund, në rang institucioni. Të dhënat e dala nga këto analiza, përmbledhen në raportin që KU “Logos” publikon në fund të çdo viti akademik. [Ref. Raporti Vjetor 2018-2019; Raporti vjetor 2019-2020 KU LOGOS].			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Referuar dokumentacionit të aksesuar, GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive, përcaktohen si në rregulloren institucionale, ashtu edhe në rregulloren e Departamentit dhe të programit specifik. Kontrolli i njohurive bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik për secilën prej lëndëve. [Ref. Rregullore e Përgjithshme e KU Logos (Kreu XII); Rregullore e Programit të studimeve (Neni 12), Syllabuset, Plani mesimor 2018-2019; Syllabuset-Plani mesimor 2019-2020; Syllabuset-Plani mesimor 2020-2021].
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, si dhe referuar RVB, konstatoi se studentët informohen nga stafi akademik në fillim të semestrit për programin e lëndës, format alternative të vlerësimit, dhe detyrimet që ata kanë dhe që janë të parashikuara në Syllabuse. [Ref. Syllabuset, Plani mesimor 2018-2019; Syllabuset, Plani mesimor 2019-2020; Syllabuset, Plani mesimor 2020-2021].
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të	Referuar syllabuseve të lëndëve të programit, GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme të ndërthura (me shkrim; me gojë; detyra kursi; projekte) të përcaktuara nga titullari i lëndës, për

demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	ti dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Përgjatë periudhës së Pandemisë Covid-19, KU “Logos” ka hartuar udhëzime dhe rregullore mbi format e testeve online (provim me video-konferencë, teste me zgjedhje të shumëfishtë, vlerësim i provimeve me libër të hapur/esse, provim me dosje elektronike), duke mundësuar mbylljen e sezoneve të provimeve. [Ref. Rregullore e KU Logos, Nenet 98-102, Neni 23; Rregullore e Fakultetit, Nenet 11-14; Rregullore e Programit të studimeve; Rregullore për provimet online-2020; Udhëzim për politikën e vlerësimit në distancë].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	GVJ referuar burimeve alternative, syllabuseve, rregulloreve dhe stafit akademik, konkludon se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, me komponente të tillë si: mini teste, provime gjysëmsemestrale, punime, ushtrime, ese, prezantime, diskutime/pjesëmarrje të studentëve dhe projekte. Pra, ekziston një vlerësim i vazhdueshëm përgjatë çdo semestrit i cili përmbyllet me provimin përfundimtar të sezonit. [Ref. Tabela 15].
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në kushtet e pandemisë të Covid 19, provimet janë zhvilluar online nëpërmjet platformave të përcaktuara. Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës ka përdorur platformën e unifikuar (Platforma Neo LMS), nëpërmjet të cilës mundësohet një mënyrë e sigurt e testimit online, duke shmangur abuzimet gjatë procesit të provimit. Publikimi i notave bëhet nëpërmjet sistemit EduPage, ku studentët marrin informacion të personalizuar me kodet e tyre të personalizuar. Njëkohësisht, bazuar në RVB, konkludohet se, kur pedagogët dyshojnë në origjinalitetin e një detyre kursi, janë të udhëzuar të kontrollojnë nivelin e ngjashmërisë, duke përdorur metoda të tilla, si Dupli Checker, Plagiarisma etj., ose instrumente më të thjeshta si Google. [Ref. Rregullore për provimet online 2020; Test me zgjedhje të shumëfishta; Test online me alternativa dhe video call].
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Referuar Rregullores së Programit, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. [Ref. Notat në Sekretari; Rregullorja e Departamentit (Kreu VIII, Neni 35.3)].
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me	Referuar vizitës në institucion dhe dokumentave të aksesuar, GVJ konstaton se testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet

<p>sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim. Sekretimi i fletës së provimit kryhet nga sekretaria e departamentit. Studenti vendos kodin e tij të sekretimit në fletën e provimit, pas korrigjimit të së cilës i bashkangjitet cover page-i, që përmban të njëjtin numër sekretimi. Gjatë periudhës së pandemisë, për zhvillimin e provimeve online, janë miratuar rregullore të posaçme për zhvillimin e provimeve.</p> <p>[Ref. Rregullore e Përgjithshme e KU Logos (Kreu XII, Neni 99, pika 6)].</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Departamenti siguron një reagim të hapur me studentët për vlerësimin e tyre, i cili ndihmon në këtë proces. Pas përfundimit të provimeve përfundimtare, studentët kanë të drejtë gjithashtu të shohin provimin e tyre dhe të diskutojnë me pedagogun e tyre rreth gabimeve.</p> <p>[Ref. Test me libra hapur].</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Pedagogët dhe Departamenti deklarojnë, që nga fillimi i vitit akademik se nuk do të lejojnë plagjiaturë në punimet e studentëve ose kopjime gjatë provimeve. Departamenti ka krijuar rregulla të veçanta në lidhje me këtë fenomen dhe gjithashtu ka një komision provimi, që mund të shqyrtojë këtë tregues në rast se ka një kërkesë nga një pedagog ose një student.</p> <p>[Ref. Vendim i Departamentit, për krijimin e komisionit të përhershëm për provimet sezonale dhe atyre të diplomimit].</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësiwe profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e KU “Logos”, personeli akademik është i detyruar, që të publikojë rezultatet e çdo detyre, apo provimi brenda 5 ditëve pune nga data e provimit. Rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet afishimit të rezultateve të provimit në procesverbalin me kode.</p> <p>[Ref. Rregullore e Përgjithshme e KU Logos (Kreu XII, Neni 99, pika 6)].</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në Rregulloren e KU “Logos” dhe në Rregulloren e Programit të Studimit “Bachelor” në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze” (Aneks 7, Neni 11, 12, 13, 14) parashikohet e drejta e çdo studenti, që të njihet personalisht me rezultatet e provimit në prani të lektorit të kursit.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, për shkak se testimet janë zhvilluar on-line, studentët kanë patur mundësinë të informohen për vlerësimin menjëherë pas provimit, kjo për metodën e provimit të zgjedhur në disa lëndë.</p> <p>Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orësh nga shpallja e rezultatit të provimit. Përgjegjësi i Departamentit, brenda 48 orësh, bën verifikimet e duhura, duke dëgjuar mendimin e pedagogut dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, ngre një komision ad-hoc. Ky komision përbëhet nga Përgjegjësi i departamentit, një anëtar pedagog i asaj disipline dhe pedagogu i lëndës. Komisioni ad-hoc bën verifikimin e pretendimeve të studentit, duke rivlerësuar tezën e provimit dhe përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit, të cilin ia komunikon studentit brenda 3 ditësh. Rezultati i rishqyrtimit duhet t’i njoftohet me shkrim pjesëmarrësit të provimit, duke e shoqëruar me informacionin e nevojshëm. Vendimi i komisionit ad-hoc, është përfundimtar.</p>

	[Ref. Test online me alternativa; Rregullore e Programit të studimeve (Neni 14)].			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Në Departamentin e Teologjisë dhe Kulturës është ngritur dhe funksionon një Komision i përhershëm me tre anëtarë, i cili monitoron dhe menaxhon të gjitha të dhënat, për realizimin e suksesshëm dhe në përputhje me të gjitha rregullat, të provimeve sezonale të lëndëve, si edhe ato të diplomimit të studentëve. Një nga përgjegjësitë e këtij komisioni është që, pasi të konsultohet me një grup ekspertësh, të shqyrtojë ankesat e mundshme të studentëve për vlerësimin e tyre në provime. Nëse ndonjë ankesë ka bazë, komisioni i paraqet rezultatet në një takim të departamentit lidhur me situatën. Komisioni ndjek procedurat, poston vendime zyrtare për çdo ankesë dhe i arkivon ato. [Ref. Vendim departamenti për krijimin e komisionit të përhershëm për provimet sezonale dhe atyre të diplomimit; Vendim departamenti për themelimin e shoqatës së studentëve të Teologjisë].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Referuar informacionit të siguruar nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezulton se metodat e përdorura, janë në funksion të thellimit të njohurive të studentëve; në leksione dhe seminare, synohet aktivizimi i studentëve, nëpërmjet rasteve studimore, detyrave të grupit, detyrave të kursit, për të zhvilluar aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve, bazuar në kurrikulën e programit, ku krahas lëndëve me karakter teologjik, jepen dhe lëndë të shkencave sociale, të cilat kontribuojnë në njohuritë historike dhe sociologjike të fenomenit fetar në Shqipëri dhe nevojat e kërkimit dhe zhvillimit të ardhshëm të kësaj shkence. [Ref. Syllabusi i lëndës “Metodologjia e Studimit Shkencor”; Syllabusi i lëndës “Organizimi i Aktiviteteve Pedagogjike”].
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Kurrikula e programit përmban kurse për Informatikë për dy semestra, gjuhë të huaja për pesë semestra (Greqisht dhe Anglisht), ndërsa syllabusi i lëndës “Hyrje në Dhiatën e Vjetër” përmban një njohuri të nivelit të parë të Hebraishtes. Programi gjithashtu ka lëndë të tilla si, “Metodologjia e studimit shkencor”, “Pedagogji”, “Sociologji”, “Etikë dhe Filozofi”, “Art dhe arkeologji”, “Muzikë” dhe “Histori”. Krahas këtyre rezulton se zhvillohen trajnime shtesë në lidhje me gjuhën shqipe dhe greke, për kërkime në bibliotekë dhe burimet dixhitale, trajnimin për TIK dhe Edukimin Fetar, Arkeologjinë Biblike, etj. [Ref. Syllabuset, Plani mësimor 2020-2021; Vendim i Departamentit “Përgatitja e Seminareve jashtë-kurrikulare].

<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga takimi me pedagogët, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen dhe shqyrtohen si në fillim, ashtu dhe në përfundim të çdo lënde. [Ref. Syllabuset].</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Gjithashtu në seancën e fundit të semestrit çdo pedagog realizon një përmbledhje të lëndës, temave kryesore dhe orienton studentët rreth testit përfundimtar, dhe adreson paqartësitë që studentët kanë. Në disa raste, rishikimi kryhet nga studentët që do të thotë se ka një diskutim të hapur, përgjigje të pyetjeve ose prezantim të një projekti që mund të tregojë për gjërat që studentët duhet të përqendrohen gjatë provimeve të tyre. [Ref. Procedura per ndryshimin e kurrikules deri ne masen 20 %].</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në RVB paraqitet se Departamenti nëpërmjet profesorëve të ftuar nga universitetet brenda dhe jashtë vendit janë trajtuar informacionet e përditësuara lidhur me lëndët për të cilat janë ftuar nëpërmjet organizimit të disa trajnimeve, si dhe është organizuar një shkollë verore. Trajnimet rezultojnë se kanë vazhduar edhe gjatë pandemisë nëpërmjet organizimeve online. <i>GVJ sugjeron që institucioni të inkurajojë personelin akademik efektiv në realizimin e orëve të hapura dhe seminareve mbi zhvillimet të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit dhe jo vetëm nëpërmjet akademikëve të ftuar në leksione.</i> [Ref. Trajnime online të studenteve].</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Referuar planit mësimor, syllabuseve, CV-ve të stafit mësimdhënës, si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, GVJ konstaton se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale, zhvillim kompetencash, si dhe aplikim i njohurive të siguruar nga teoria. [Ref. Shembull nga Lënda Historia e Religjioneve].</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik inkurajon dhe mbështet studentët të përfshihen në diskutime, aktivitete dhe detyra grupi për lëndë të ndryshme edhe pse ka në përbërje një numër të vogël studentësh. [Ref. Vendimet dhe programi për Orët e Bashkëpunimit me Studentët].</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Stafi akademik mundohet të ofrojë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve, të cilat gjejnë edhe mbështetjen institucionale. Kërkimet më të vlerësuara të studentëve mbështeten dhe botohen në revistën studentore "Fjala". [Ref. Rregullorja për Tezën e Diplomës dhe tabela e vlerësimit; Syllabus-Punimi i Diplomës 2020-2021].</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Studentët e programit të Studimeve Bachelor në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze mbulojnë me bursë të plotë nga Fondacioni Logos për të kryer studimet e tyre dhe jetojnë pa kosto në konviktet e kampusit 2 në Shën Vlash, Durrës (të paktën gjatë periudhës para pandemisë). Përveç kësaj mbështetjeje, studentët marrin falas të gjithë materialin dhe botimet e tyre (të shtypura dhe dixhitale), por gjithashtu ata kanë mbështetjen nga Institucioni për të shtypur projektet dhe punën e tyre në gazetën "Fjala". Gjithashtu, studentët kanë mundësinë</p>

	të prodhojnë një emision radiofonik “Fjala Live” (https://soundcloud.com/theolkulogos) në Radio “Ngjallja” (88.5 MHz). [Ref. Aneks 18.2, Bursa Teologji 2018-2019; Aneks 18.3 Bursa Teologji 2019 - 2020; Aneks 18.4, Bursat LOGOS-20-21]. https://issuu.com/departamentiitheologjisedhekultures			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Departamenti ka një bashkëpunim zyrtar ERASMUS+ KA-1 me Universitetin e Finlandës Lindore në lidhje me studentët dhe personelin akademik, por për arsye se ky bashkëpunim u realizua në prag të pandemisë, nuk ka patur ndonjë zhvillim në mobilitetin e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Departamenti posedon një Rregullore për Diplomimin dhe një rregullore të veçantë për tezën. Gjatë vitit, publikohen vendime në lidhje me titujt e tezës së studentëve dhe mbikëqyrësit e tyre, komisionet e vlerësimit, si dhe komitetet e vlerësimit në lidhje me provimet e diplomimit. Mbështetur në Rregulloren e Diplomimit, studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Bazuar në RVB, rezulton se studentët informohen në fillim të vitit gjatë një seance të veçantë, si dhe gjithashtu ata kanë mundësi t’i kontrollojnë vendimet dhe rregulloret në Guidën e Studentit, që i shpërmdahet atyre në fund të vitit paraardhës. [Ref. Rregullorja e Diplomimit e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës; Rregullorja e Departamentit (Kreu IX, Neni 40, pika 40.1-40.2); Student Guide 2019-20; Aneks 46.2 Student Guide 2020-21; Student Guide 2021-22].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Studentëve u vihen në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës nga sekretaria mësimore, pedagogu udhëheqës i temës së diplomës, si dhe pedagogët të cilët kanë hartuar bankën e pyetjeve. [Ref. Aneks 44.29 Vendim Departamenti].
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Programi i provimit final bazohet në njohuritë e marra gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë dhe miratohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit. Studentët marrin të gjithë materialin e nevojshëm për provimin e diplomimit, si dhe kanë mundësinë të përgatiten, të bëjnë pyetje ose të organizojnë seanca të veçanta për përsëritjen ose marrjen e shpjegimeve mbi aspektet specifike të provimeve në takime të hapura ose online, që zhvillohen nga departamenti.

	[Ref. Orari Mësimor].
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Bazuar në evidenca dhe në intervista me studentët, rezulton se studentët marrin të gjithë materialin e nevojshëm për provimin final, apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave, si dhe zhvillohen takime të hapura për konsulta në auditor dhe gjatë pandemisë online me mbikëqyrësit e tyre. [Ref. Orari mësimor; minutat e intervistës].
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Studentët kanë mundësi për të kryer dhe botuar kërkimet e tyre nëpërmjet platformave dixhitale dhe botimit të analizave dhe punimeve të tyre në revistën studentore, ku botojnë materialet e tyre në bazë të temave dhe fushës së studimit. [Ref. Vendim departamenti, pranimi i temave].
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në rregulloren e Departamentit, udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e tezës sipas udhëzimeve të miratuara, duke garantuar cilësinë e rezultateve dhe miratuar ose jo punimin për t'u paraqitur para komisionit. [Ref. Rregullorja për Tezen e Diplomes dhe tabela e vlerësimit; Vendimi i Departamentit mbi Komisionet e Tezave].
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas rregullore për tezën çdo anëtar i komisionit vlerëson me notë studentin dhe më pas i njoftohet atij mesatarja e vlerësimit. I njëjti proces ndiqet edhe në vlerësimin e lëndëve të provimeve të diplomimit. Komisioni pas provimit të secilit student vlerëson performancën e tij/saj dhe më pas shpall rezultatet. [Ref. Rregullorja për Tezën e Diplomës dhe tabela e vlerësimit; vendim departamenti për mënyrën e zhvillimit të provimeve të diplomimit].
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Referuar dokumentacionit të konsultuar, GVJ konkludon se institucioni pajis me diplomë, listë notash dhe suplement diplome të miratuara nga MASR çdo student i cili ka plotësuar detyrimet e programit. Suplementi i diplomës është i hartuar në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Elementet përbërëse të diplomës, forma e saj, shtojca dhe procedurat e regjistrimit të diplomave përcaktohen nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. [Ref. Rregullore e Përgjithshme e KU Logos; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor].
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve për Programin e Studimit Bachelor në "Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjose", studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e notave, sipas formatit të miratuar nga MASR si dhe kopjen e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. [Ref. Urdhër rektori për procedurën e konfirmimit të dokumentacionit akademik të studentëve, të lëshuar nga KU "Logos"].
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Sipas rregullore institucioni ruan të dhënat e studentëve dhe arkivon një kopje të vërtetuar dhe një kopje elektronike të diplomave të tyre dhe mban një regjistër të arritjeve akademike të studentëve. Regjistri i Dorëzimit të Diplomave dhe Certifikatave ruhet përherë për sa kohë që funksionon KU LOGOS. Afatet e ruajtjes së llojeve të ndryshme të

	dokumentacionit të studentit, ndiqen sipas Rregullores së Arkiv-Protokollit. [Ref. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor; Statuti].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Çdo vit akademik institucioni mbledh dhe përditëson të dhënat e personelit akademik, të rekrutuar sipas nevojave të propozuara nga departamenti. Zyra e burimeve njerëzore menaxhon dosjet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe harton dhe ndjek procedurat për rekrutimet e reja.</p> <p>Ekziston gjithashtu edhe një skedar i dytë arkivor për çdo anëtar të personelit nga sekretari i Departamentit (në Kampusin Nr. 2 në Shën Vlash), në të cilin mblidhen, ruhen dhe përditësohen angazhimet e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program dhe personat përgjegjës për organizimin e programit të studimit Bachelor në “Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze”.</p> <p>[Ref. Politika dhe procedura te Burimeve Njerezore].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Procedura e rekrutimit të personelit akademik në KU “LOGOS” realizohet në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Kodin e Punës, në Statut, si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të institucionit. Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore harton dhe zbaton procedura të përgjithshme dhe specifike (të përcaktuara nga Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës) për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e programit të studimit. Zyra e Burimeve Njerëzore shpall thirrjen online në faqen web të institucionit për vendin vakant, si dhe përgatit komisionin e vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në aktet e brendshme të rregullores së KU “Logos”. Vendimi më pas ndiqet deri në momentin e rekrutimit përfundimtar.</p> <p>[Ref. Statuti; Rregullorja e IAL-së; Paketë Rekrutimi].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Referuar procedurës së rekrutimit, si dhe asaj të konsultuar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni harton kërkesa të përgjithshme, kritere bazë si dhe kritere preferenciale për stafin e programit. KU “Logos”, në fillim të çdo viti akademik evidenton nevojat për personel akademik, nevoja këto, të cilat evidentohen nga njësia bazë dhe më tej pas miratimit nga Dekanati, përcillet kërkesa te Rektori. Mundësitë për rekrutimin e personelit akademik shqyrtohen në respekt të numrit të miratuar paraprakisht nga Bordi i Administrimit. Në vijim, ngrihen komisionet ad-hoc të rekrutimit në nivel njësie bazë, të cilat pas miratimit nga Dekani, Administratori dhe miratimit përfundimtar nga Rektori, në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore ndjekin procedurat e rekrutimit, duke shpallur vendet vakante të miratuara dhe duke organizuar procedurën e konkurrimit nëpërmjet dosjes së kandidatëve dhe intervistës ballë për ballë. Vlerësimi kryhet nëpërmjet tabelës së pikëzimit të kandidatëve ku 40 % të vlerësimit e zë intervista. Pas shpalljes fitues ose jo, kandidatët marrin njoftimin përkatës nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>[Ref. Paketë rekrutimi dhe përzgjedhjeje për personel akademik me kohë të pjesshme; Politika dhe procedura të Burimeve Njerezore].</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>KU “Logos” në punësimin e personelit ndihmës akademik dhe personelit administrativ, zbaton Kodin e Punës, aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe aktet e brendshme rregullative të institucionit.</p> <p>Bazuar në RVB, intervistave dhe takimeve në IAL, rezultojnë se gjatë tre viteve të fundit janë rekrutuar disa anëtarë të personelit, që kanë kryer studime universitare jashtë vendit, fushat e të cilëve janë në përputhje me lëndët që mbulojnë në mësimdhënie.</p> <p>[Ref. Rregullore e KU Logos; Statistika mbi kualifikimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme; Syllabuset-Plani mësimor 2020-2021; CV-të e stafit akademik të programit të studimit; Ngarkesa totale e personelit akademik të programit].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultojnë se IAL ka siguruar investime të cilat ofrojnë mjedise dhe zyra me kushte komode për stafin akademik dhe atë joakademik.</p> <p>[Ref. Infrastruktura].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton në planin strategjik të institucionit si prioritet zhvillimin profesional dhe akademik të stafit. Referuar takimeve me GVB, me stafin e programit, si dhe drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezultojnë se institucioni mbështet stafin akademik në trajnime të ndryshme në fushën e mësimdhënies, duke i mundësuar angazhimin në konferenca, revista shkencore, etj.</p> <p>Departamenti gjithashtu ndihmon stafin në përmirësimin e performancës së tyre akademike nëpërmjet seminareve që organizohen, si dhe ka nxitur stafin akademik t’i lëjë hapësirë për të vazhduar studimet doktorale.</p> <p><i>RVJ sugjeron rritjen e numrit të partneriteteve dhe mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve.</i></p> <p>[Ref. Informacion për zhvillimin, integrimin dhe pjesëmarrjen e personelit të Kolegjit Universitar “LOGOS”; Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe intervistat në IAL, rezultojnë se departamenti ka zhvilluar një programin të veçantë arsimor të quajtur “Educational Tips”, i cili përqendrohet në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies, sidomos gjatë mësimdhënies online. KU Logos ka organizuar gjithashtu trajnime për përdorimin e teknologjive të reja të mësimdhënies, si dhe është realizuar ngritja e sistemit të brendshëm informues Teams.</p>

	[Ref. Trajnim për platformen Microsoft Office 365; Manuali i përdorimit të Office 365, Teams për Lektorët; Teams për Studentët].			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Referuar strukturës organizative të institucionit, stafit akademik dhe joakademik të përfshirë në program, informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, rezulton se IAL vë në dispozicion të programit të studimit staf të angazhuar dhe optimizion përdorimin e burimeve njerëzore për realizimin e objektivave të këtij programi. Për këtë institucioni vlerëson performancën nëpërmjet formularëve të vetëvlerësimit, vlerësimeve nga drejtuesit e njëjësive kryesore, si dhe pyetësorëve nga studentët të realizuar në fund të çdo semestri. [Ref. Vleresime te kryera nga NJSBC].			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar vizitave në IAL, KU “Logos” e ushtron aktivitetin e tij në dy kampuse. Në godinën e kampusit nr. 2 të institucionit zhvillojnë aktivitetin e tyre akademik dhe administrativ studentët dhe personeli akademik i Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës, të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikutimit Gjuhësor. Kampusi nr. 2 ka një sipërfaqe 2.117 m ² , me vendndodhje në adresën: Shën Vlash, Durrës. Objektet në shërbim të institucionit sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin me standarde bashkëkohore të procesit mësimor në përputhje me natyrën specifike të programit të teologjisë dhe moduleve përkatëse. [Ref. Relacion mbi Infrastrukturen 2020; Mjediset e Fakultetit dhe Njësive Bazë].
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Infrastruktura e institucionit është e përshtatshme për mësimdhënie dhe përmban klasa me hapësira të bollshme, si dhe salla konferencash të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike për të zhvilluar arsimim cilësor. Çdo sallë leksioni dhe seminari është e pajisur me kompjuter portativ dhe videoprojektor për zhvillimin e mësimimit me cilësi të lartë. [Ref. Mjediset e Fakultetit dhe Njësive Bazë].
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion rezulton se është ngritur laborator i informatikës, i veçantë për kampusin nr. 2, i cili përmban 11 kompjuterë të qëndrueshëm. Ky laborator përdoret jo vetëm për lëndën e Informatikës, por është në dispozicion të studentëve edhe për punimet e tyre të çdo lënde dhe studimet e orëve të pasdites, duke i ardhur në ndihmë atyre për një përgatitje sa më efektive. Gjithashtu,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	biblioteka është përdorur për workshop-e dhe aktivitete laboratorike, pasi ajo ka pajisjet e nevojshme edhe për aktivitetet teknologjike. [Ref. Mjediset e Fakultetit dhe Njësive Bazë].			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Krahas laboratorit të kompjuterave të ngritur në kampusin e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës, mundësitë e platformës elektronike të komunikimit MS TEAMS dhe Wifi (free) i jep studentëve mundësinë, që të kthejnë pajisjen e tyre si një minilaborator të teknologjisë së informacionit me programe profesionale sipas natyrës së programit të tyre. [Ref. Mjediset e Fakultetit dhe Njësive Bazë].			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Institucioni garanton kapacitete të mjaftueshme për formimin praktik të studentëve në programet e fushave që ofron. Departamenti i Teologjisë shtrihet në një kampus të gjerë dhe ambiente të mjaftueshme për përgatitjen praktike të studentëve dhe mund të mirëpresë çdo aktivitet akademik. IAL në shërbim të programit të studimit ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, si dhe me Fondacionin “Frymë Dashurie”, për realizimin e praktikave mësimore të studentëve. <i>RVJ sugjeron shtrirjen më të gjerë të praktikave edhe në institucione tjera, sidomos ato arsimore dhe edukative.</i> [Ref. Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese; Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve për këtë program studimi bibliotekën mësimore. Studentët kanë të drejtë të anëtarësohen në bibliotekë dhe të përdorin literaturën, si fizike dhe atë elektronike, në mjediset e bibliotekës. Gjithashtu ata kanë të drejtë të huazojnë literaturën, që iu duhet jashtë mjediseve fizike të bibliotekës. Biblioteka e kampusit është e disponueshme për studentët, jo vetëm gjatë orëve të mësimin, por edhe pas përfundimit të tyre. [Ref. Rregullorja e bibliotekës Logos; Orari i Bibliotekës].
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka në kampusin e Shën Vlashit është e pajisur me 19.520 tituj, të ndarës sipas njësive të tyre bibliotekare, që mbulojnë të gjitha lëndët bazë të kurrikulës së programit të studimit, si dhe me një sasi të konsiderueshme literature ndihmëse, si për kurrikulat, ashtu edhe për kërkimin shkencor. Biblioteka posedon literaturë në shqip, greqisht, anglisht dhe në gjuhë të tjera evropiane. Bazuar në RVB gjatë tre viteve të funksionimit të Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës, biblioteka është pasuruar me më shumë se 500 tituj, libra të rinj, revista, e-libra dhe e-periodikë.

	[Ref. Biblioteka "Ngjallja" Total; Titujt e rinj 2018-2021].
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Bazuar në RVB dhe në intervist me studentët, institucioni ka krijuar kushte për përdorimin falas të bazave të të dhënave online për kërkimin e librave elektronikë, revistave elektronike dhe enciklopedive, që janë të rëndësishme për studimet e tyre në programin e ciklit të parë. Studentët, duke përdorur platformën e të nxëniet elektronik të Departamentit, mund të lidhen me këto baza të të dhënave online (studentët trajnohen gjatë vitit të tyre të parë të studimeve se si t'i përdorin ato). Gjithashtu, gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, studentët kanë përdorur katalogun elektronik të Bibliotekës, duke bashkëpunuar me punonjësen e bibliotekës për sigurimin e materialit nëpërmjet skanimit etj, natyrisht duke respektuar të drejtat e autorit. Studentëve u ofrohen prej pedagogëve adresa elektronike të aksesueshme falas në shërbim të programit, gjë që mundëson përdorimin e literaturës së huaj. [Ref. Vendim Departamenti i Teologjisë-Përdoruesit e bibliotekës 02.10.2019; Korespondenca me studentët gjatë pandemisë].
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka është e pajisur me kompjutera në të cilët janë instaluar disa programe themelore kompjuterike për kërkim teologjik, të tilla si Diogenes, TLG dhe BibleWorks, që përdoren në të gjithë botën në studimet teologjike dhe çdo student dhe anëtar i Departamentit mund t'i përdorë ato falas. Fondi i Bibliotekës paraqitet në bazën e të dhënave elektronike përmes regjistrimeve në programin e katalogimit të përbashkët elektronik PLEIADES bazuar në standartin MARC 21. Katalogu elektronik ndihmon cilindo në gjetjen e informacionit që disponon fondi i bibliotekës. Duke qenë se Biblioteka disponon materiale audio-vizuale në fondin e saj, ajo siguron pajisjet e nevojshme për shfrytëzimin e tyre. Në dispozicion të Bibliotekës janë dhe 2 pajisje multifunksionale printer, skaner dhe fotokopje. [Ref. Plani Strategjik për programin-Raport 2021].
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Bazuar vizitës në institucion, rezulton se Fondi i Bibliotekës ka materiale të shumta në shqip dhe në gjuhë të huaja, e cila pasurohet vazhdimisht nëpërmjet blerjes, shkëmbimit, dhuratave dhe abonimeve. Përveç kësaj, nëpërmjet bashkëpunimit me shtëpitë botuese është mundësuar sigurimi i titujve teologjikë falas në bibliotekë dhe pasurimi e literaturës së programit. Sipas RVB dhe evidencave, departamenti rezulton gjithashtu se ka marrë vendime për të kërkuar blerjen e titujve të rinj, të cilët janë themelore për programin e studimit. Prej këtyre, rezulton se Biblioteka ka një plan të detajuar strategjik për përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit të studimit, i cili mbështetet me fonde vjetore. [Ref. Vendim i Departamentit të Teologjisë-Librat për Kurset dt. 25.11.2019].
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të	Biblioteka është e disponueshme për studentët nga e hëna në të premte nga ora 08:00-23:00 dhe fundjavave nga ora 14:00- 23:00. Ky orar specifik afishohet në hyrje të Bibliotekës. Sipërfaqja e bibliotekës është 118 m ² dhe i përmbush kushtet e një biblioteke bashkëkohore.

nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e kampusit nr. 2 është e disponueshme për studentët tërë ditën, jo vetëm gjatë orëve të mësimit, por edhe pas përfundimit të tyre. [Ref. Orari i Bibliotekës].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Referuar RVB, vizitës në institucion, si dhe evidencave, GVJ konstaton se KU "Logos" disponon një sistem të menaxhimit të informacionit, që siguron akses për këta përdorues: studentët, stafin akademik, sekretaritë, si dhe zyrën e IT. Përveç sistemit elektronik për studentët informacioni mbahet edhe në formë shkresore, nëpërmjet rregjistrimit themeltar, rregjistrimit të përparimit akademik të studentëve, si dhe rregjistrimit të lëshimit të diplomave, regjistra këto të cilat u konstatuan nga ana e GVJ gjatë vizitës në institucion dhe që rezultuan me informacionin e plotë të kërkuar.</p> <p>Spektori TIK në KU "LOGOS" mbështet gjithashtu njësitë e tjera dhe kujdeset për bazën e të dhënave dhe sistemet (EDU Page dhe TEAMS) për mbledhjen, përpunimin dhe transmetimin e të dhënave, që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike, që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Gjithashtu dosja personale e çdo studenti ruhet fizikisht (hard copy) nga sekretaria mësimore, si dhe në formë elektronike në database nga departamenti përkatës.</p> <p>[Ref. Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale; Shembull i dosjes personale të studentit].</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore e institucionit bazuar në RVB dhe vizitës në IAL, rezulton se administron dhe mbledh informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit: diplomat, arrijtet akademike, CV-të dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për çdo personel që ka punuar dhe kontribuar në programin e studimit. KU "Logos" ka ngarkuar me detyrë për mbledhjen dhe raportimin e statistikave Zyrën e Administratorit të Fakulteteve. Çdo njësi në përputhje me natyrën e punës angazhohet në përpunim të statistikave të ndryshme nga viti në vit dhe ato i përcillen Zyrës së Administratorit të Fakulteteve, e cila bën raportimet respektive në MASR, etj. Kjo zyrë vendos gjithashtu në dispozicion të njërive brenda KU "Logos" të gjitha statistikave, që disponon me qëllim kryerjen e studimeve, apo kërkimeve të nevojshme për miradministrimin e institucionit, apo programeve mësimore të afuara nga ky IAL.</p>

	Sektori i IT po ashtu kujdeset për digjitalizimin e të dhënave dhe ruajtjen e dokumentacionit në formë elektronike. [Ref. Politika dhe procedura te Burimeve Njerezore; minutat e intervistës].			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi Edupage që disponon universiteti ofron akses mbi informacionin sipas nevojës, duke u bazuar në një ndërfaqe web, e cila mund të aksesohet nga çdo përdorues. Përmes këtij sistemi elektronik sigurohet akses i dedikuar në informacione dhe dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. [Ref. https://kulogos.edupage.org/].			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Bazuar në RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se komunikimet interaktive realizohen nëpërmjet aplikacionit Microsoft Teams, i cili përveç komunikimit interaktiv i jep mundësinë studentëve dhe stafit të kenë ambjente bashkëpunimi, vende për ndarjen e materialeve të ndryshme. Sektori i IT është përgjegjës për zbatimin dhe mirëmbajtjen e platformës së sistemit digjital (TEAMS) ku arkivohen leksionet, detyrat, provimet dhe çdo komunikim tjetër mes stafit akademik dhe studentëve. Departamenti i Teologjisë përdor gjithashtu platformën NEO LMS për të dërguar mesazhe të sigurta, njoftime për lëndët, njoftime shkollore dhe mesazhe personale midis lektorëve dhe studentëve. Një mënyrë tjetër e një komunikimi më të shpejtë janë Skype, EhatsApp dhe Viber. [Ref. Shembull nga Teams-Mësimdhënie; Students-Guide NEO-LMS; Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit-Guide NEO LMS lektorët].			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi elektronik i informacionit të manaxhimit, rezulton një sistem i integruar me platforma dhe module, që suportojnë komunikimin interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik. Platformat në kohë reale japin informacion mbi pjesëmarrjen e studentëve në një lëndë, nëse ata e kanë studiuar materialin, progresin që kanë bërë, notat që kanë marrë dhe statistika të tjera. [Ref. Shembull nga Teams-Statistika].			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Bazuar në RVB rezulton se informacionet e nevojshme, që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit të institucionit (http://www.kulogos.edu.al) dhe të Departamentit (https://theolkulogosalb.ëordpress.com/) në shqip dhe anglisht. Ndërkohë, informacionet lidhur me departamentin pasqyrohen edhe në mediat sociale të KU "Logos" dhe ato të departamentit. <i>RVJ sugjeron që webfaqja e internetit të jetë më e decentralizuar, duke krijuar mundësi edhe për kalimin në faqe interaktive të çdo njësie kryesore, për të ofruar një organizim më efektiv të informacionit për kategori specifike përdoruesish të interesuar për Departamentin e Teologjisë, siç janë psh. rubrika e stafit dhe aktivitetet e departamentit.</i> [Ref. Kriteret perkatëse nga faqja e WEB; Kontaktet e departamentit].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstaton se në zbatim të legjislacionit në fuqi, KU “Logos” harton një raport vjetor. Pjesë e këtij raporti rezulton të jetë edhe raportimi financiar. Analiza e të dhënave për periudhën 3 vjeçare, që nga momenti i fillimit të programit të studimit në vitin akademik 2018-2019, tregon mbështetjen nga donacionet dhe burime të tjera, realizuar nga Fondacioni “Logos” për mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>Megjithatë GVJ nuk konstatoi plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për një cikël të plotë studimi, si dhe sugjeron që raporti vjetor të publikohet edhe në faqen web të institucionit.</i></p> <p>[Ref. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit].</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit është i hartuar në rang institucional. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore në total, shërbimet operative për mirëmbajtjen, shpenzimet për studime e bursa, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, detyrimet financiare, grantet vendëse, apo të huaja të përfituara, etj.</p> <p>Në përputhje me përcaktimet ligjore, njësia bazë dërgon kërkesat lidhur me hartimin e projektbuxhetit në përputhje me nevojat, interesat e institucionit dhe planin strategjik të zhvillimit. Më pas bëhet miratimi i kërkesave të tyre, të cilat reflektohen në zëra konkretë të buxhetit.</p> <p>[Ref. Tabela e godinave të kampuseve; Udhëzues për hartimin e buxhetit; Sugjerimet e njësisë bazë mbi përpilimin e Projekt-Buxhetit të KU LOGOS].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Bazuar në RVB, në zbatim të ligjit të arsimit të lartë për auditimin e aktivitetit financiar, nëpërmjet vendimit të Bordit Drejtues të Fondacionit përcaktohet Eksperti Kontabël i Autorizuar, i cili realizon procedurën e auditimit të jashtëm të institucionit në zbatim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit të pasqyrave financiare. Në Raportin e Auditimit jepen pasqyrat financiare, politikat kontabël dhe ato të sistemit të kontrollit të brendshëm. Raporti i Audituesit të jashtëm i paraqitet Bordit Drejtues të Fondacionit dhe bashkëshoqëron pasqyrat financiare të vitit financiar respektiv. Raporti i Auditit financiar përmban informacion të detajuar mbi shkallën e plotësisë së objektivave strategjike të institucionit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, konsolidimin e procesit kërkimor, si dhe ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>[Ref. Raport i Auditimit 2019].</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe</p>	<p>Bazuar në RVB, në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare, jo vetëm të një viti akademik por bën një analizë krahasuese të zërave të buxhetit ndër vite dhe planifikon</p>

<p>diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>ndërhyrjet e posaçme të financimit të institucionit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p>Institucioni bën analizën vjetore të shpenzimeve dhe të ardhurave duke, nxjerrë arsyet e mosplotësimeve (nëse ka të tilla) dhe i raporton Bordit Drejtues të Fondacionit dhe Bordit të Administrimit.</p> <p>Nga ana tjetër institucioni bën axhustimin e buxhetit afatmesëm (3-vjeçar) çdo vit dhe raporton për çdo ndryshim qoftë në realizim ose mosrealizim të zërave përkatës të buxhetit, duke argumentuar secilën situatë në organet përkatëse. Institucioni bën gjatë vitit gjithashtu ndjekjen periodike të realizimit të buxhetit.</p> <p>Ky vit përbën mbylljen e një cikli të plotë studimi, i pari për programin e studimit Bachelor në “Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjose”.</p> <p>[Ref. Sugjerimet e njëjësive bazë mbi përpilimin e projekt-buxhetit të KU LOGOS; Raportimi financiar 2020; Miratim i projekt-buxhetit 2020].</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në RVB, KU “Logos” ka një stabilitet financiar, si pjesë e Fondacionit “Logos”, i cili e mbështet dhe inkurajon funksionimin normal lidhur me veprimtarinë kërkimore - shkencore dhe edukative të institucionit. Strukturat përkatëse sigurojnë, që institucioni të ketë kapacitetet e mjaftueshme infrastrukturore dhe të burimeve njerëzore, si dhe bashkëpunojnë për zhvillimin e institucionit.</p> <p><i>Megjithatë GVJ është e mendimit se IAL duhet të sigurojë forma alternative të gjenerimit të fondeve në të ardhmen nga projektet e financuara nga AKSHI, projekte të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, etj.</i></p> <p>[Ref. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në</p>	<p>Sipas RVB dhe intervistave në institucion, KU “Logos” harton dhe zbaton politika dhe procedura, që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe</p>

<p>përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>aktet e veta rregullatorë. Pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhet në përputhje me kriteret dhe kuotat e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në webfaqen zyrtare të institucionit. Vendimet për kriteret e pranimit merren në Senat, në bazë të rekomandimeve të dhura nga departamentet e KU "Logos" dhe komunikohen përmes kanaleve zyrtare, si edhe nëpërmjet fushatave promovuese.</p> <p>[Ref. Statuti; politika e marketingut të programit të studimit; Vendim për Komisionin e Pranimeve; Lista e aplikantëve për program të II studimi; minutat e intervistës].</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ referuar evidencave, si dhe informacionit gjatë takimit me studentët e programit është e mendimit se aktet rregullatorë, ku sanksionohen politikat dhe procedurat që ndiqen nga hyrja në dalje e studentëve, ofrojnë trajtimin e drejtë dhe të barabartë të studentëve mbështetur mbi meritokracinë. Referuar këtu politikave të pranimit, atyre të frekuentimit, të ankimimit, si dhe të vlerësimit të arritjeve akademike të studentëve.</p> <p>KU "Logos" ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të huaj/trojet, të cilët interesohen për të ndjekur programet e studimeve që ofrohen. Studentë të regjistruar shtetas të huaj/troje, që ndjekin ose kanë ndjekur studimet nga 2017-2020 rezultojnë se janë dy në Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze. Në Rregulloren e institucionit mbi paanshmërinë, parashikohet se "Personeli i Kolegjit Universitar "Logos" gjatë kryerjes së detyrave të tij nuk mund të bëjë diskriminime mbi baza etnike, gjuhësore, racore, politike, mendimi, filozofike dhe fetare."</p> <p>[Ref. Mjetet e komunikimit me studentët; Rregullore e Përgjithshme e KU "Logos"].</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni jep informacion të vazhdueshëm për kandidatin dhe studentin lidhur me kriteret, procedurat e pranimit dhe procesin e transferimeve të studimeve, të cilat i bën publike në mjediset e tij dhe në webfaqen zyrtare, si dhe fletëpalosjeve, broshurave informative, ditëve të informimit dhe këshillimit të karrierës me maturantët realizuar në shkollat e mesme, ditët e hapura si dhe ditët e karrierës.</p> <p>[Ref. Fletëpalosja e Departamentit; Materiale informuese; Broshura; Aktivitetet në Ditët e Informimit dhe Këshillimit; Pranimi i studentëve të rinj].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Referuar takimeve me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se departamenti dhe fakulteti hartojnë përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve, të cilat bëhen publike në webfaqen zyrtare të institucionit www.kulogos.edu.al</p> <p>[Ref. Statuti; Politika e marketingut të programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë</p>	<p>Referuar takimit me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, konstatohet se kriteret e pranimit dhe kuotat për secilin program studimi janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të MASR, si dhe të Maturës Shtetërore. Në kriteret e parashikuar për çdo vit parashikohet edhe pranimi i studentëve të huaj/trojet.</p>

edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Për studentët e huaj ka një seksion të veçantë në faqen e internetit, ku shpjegohet i gjithë procesi i kriterëve dhe hapat e nevojshëm për qëndrimin e tyre në Shqipëri. https://theolkulogosalb.wordpress.com/pranimet https://theolkulogos.wordpress.com/admissions/ [Ref. Kriteret e pranimit të studentëve; Vendim për Komisionin e pranimeve].		
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se KU “Logos” dhe strukturat e tij, organizojnë ditët informuese në shkollat e mesme të qytetit për të informuar publikun, por dhe për të promovuar ofertën akademike të programeve të studimit. Gjithashtu një formë tjetër rezultoi edhe zhvillimi i open days në mjediset e institucionit me qëllime informimin e maturantëve të interesuar, shpërndarja e broshurave informuese, si dhe publikimi i kriteret e pranimit në webfaqen e universitetit dhe mediat sociale të departamentit. Mjete të tjera janë dhe programet radiofonike, si dhe panairët “Work & Study”, që organizon Ministria në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë të Tiranës. [Ref. Rrjetet sociale të departamentit; Panairi Eork and Study].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nëk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Fërmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga vizita në institucion si dhe nga RVB, GVJ konstaton se KU “Logos” ofron informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret, që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregulloren e Fakultetit, rregulloren e Departamentit, si dhe programit të studimit. GVJ vlerëson se ky informimin bëhet në forma alternative, fizikisht nëpërmjet sekretarisë mësimore, fletëpalosjeve informuese, kalendarit akademik, si dhe në webfaqen e departamentit. [Ref. Rregullorja e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës; Kalendarit Akademik 2020-2021].
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	GVJ referuar takimit me drejtues të njësisë kryesore, rezulton se procesi i transferimeve realizohet nga njësia bazë dhe specialistët e saj në bashkëpunim me njësitë kryesore, të cilat e realizojnë këtë proces në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin, rregulloren dhe aktet të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Vendime përkatëse bazohen edhe te Rregullorja e Transferimeve. KU “Logos” bën publike në mjediset e tij dhe në webfaqen zyrtare hapjen e procedurës së transferimeve dhe regjistrimeve, duke bërë me dije dokumentet e kërkuara dhe gjithë procedurën që do të ndiqet.

	[Ref. Statuti; Rregullorja e Transferimeve].			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga takimi me studentët dhe stafin akademik të programit, rezulton se në fillim të çdo semestri, pedagogët e lëndëve informojnë studentët për programin e lëndës, procedurat e kontrollit të dijeve, skemën e vlerësimit të dijeve, si dhe detyrimet lëndore për studentët. [Ref. Syllabuset, Plani mesimor 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021].			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se institucioni që në fillimin e ciklit të studimit e informon studentin mbi vijueshmërinë e tij akademike nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tij. Departamenti ka një rregullore specifike për diplomimin dhe gjithashtu një rregullore për hapat e zhvillimit të një teze. Rregullorja e tezës përmban hyrjen për qëllimin e tezës dhe kush kualifikon të shkruajë tezë, procedurën e dorëzimit dhe përgatitjes së saj, si udhëzime të përgjithshme për shkrimin e tezës. Të gjitha këto informacione përmenden në guidën e studentit, si dhe në silabusin për tezën. [Ref. Rregullorja e Diplomimit; Rregullorja për Tezën e Diplomës; Guida e Studentit 2019-2020; Syllabus-Punimi i Diplomës 2020-2021; Korespondencë me pedagogun për tezën e diplomës].			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konstaton nga konsultimi i evidencave dhe RVB-së se KU "Logos" organizon fushata informimi për njohjen e kandidatëve për studentë me ofertën akademike, institucionin, mënyrat e zhvillimit të procesit mësimor e formues të studentëve, rreth 6 muaj përpara fillimit të çdo viti akademik. Institucioni informon palët e interesuara nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit, fletëpalosjeve, broshurave informative, ditëve të informimit dhe këshillimit të karrierës me maturantët, realizuar në shkollat e mesme, ditët e hapura, si dhe ditët e karrierës. Në këto ditë KU "Logos", në bashkëpunim me shkollat e mesme, organizon vizita informuese në mjediset e tij lidhur me programet e studimit, kriteret e pranimit, infrastrukturën në funksion të programeve, personelin akademik, mundësitë e punësimit, etj. [Ref. Vendim Rektorati për organizimin e fushatës së informimit; Pranimi i studentëve të rinj, aktivitetet; Vendim Departamenti i Teologjisë, Kampet Verore].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstatoi nga takimet me drejtues të njësisë bazë, me stafin e programit, sekretarinë dhe studentët së Departamenti, si dhe sekretaria mësimore informojnë studentët në lidhje me strukturën e organizimit të programit.

	<p>Për student e vitit të parë, organizohet në fillimin e çdo viti akademik aktiviteti “Njihu me Kolegjin Universitar “Logos”. Gjithashtu organizmat studentore si “Këshilli Studentor” shërbejnë për informimin e studentëve, apo adresimin e problematikave të tyre në organet përkatëse. Mjete të tjera informimi janë dhe webfaqja zyrtare e KU “Logos”, platforma e EduPage dhe TEAMS, rrjetet sociale, komunikimi nëpërmjet adresave elektronike të pedagogëve dhe studentëve, ku studentët informohen lidhur me orarin mësimor, njoftimet mbi aktivitetet, workshopet apo konferencat, oraret e pritjeve nga pedagoget, informimi mbi silabuset etj. Institucioni disponon gjithashtu mjete komunikimi të brendshme, si njoftime me postera brenda institucionit, si dhe komunikim verbal në auditor.</p> <p>[Ref. Njihu me Kolegjin Universitar LOGOS; Mjetet e komunikimit me studentët].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët informohen nga strukturat e mësipërme për të dhënat e vitit akademik, për kalendarin e provimeve dhe për orarin mësimor.</p> <p>Gjatë ditës së informimit për studentët, atyre i vendoset në dispozicion dosja me rregulloren, statutin, rregulloren e programit, kodin e etikës, orarin, kalendarin akademik, etj.</p> <p>[Ref. Njihu me Kolegjin Universitar LOGOS; Aktivitetet për vitet akademike 17-20].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në RVB, Zyra e çështjeve studentore informon studentët nëpërmjet adresës së e-mailit studenti@kulogos.edu.al në mënyrë të vazhdueshme lidhur me mundësitë e punësimit dhe i mbështet ata për t'u integruar në tregun e punës, duke organizuar aktivitete si: Si të ndërtojme CV, letër motivimi, panaiet e punës, etj.</p> <p>Departamenti po ashtu ka formular programin e veçantë të mentorimit “Ndërto karrierën tënde” dhe gjithashtu ka botuar guidën e karrierës për të ndihmuar studentët të ndërtojnë profilin e tyre profesional dhe të fillojnë të krijojnë mundësitë për të punuar pas diplomimit të tyre. Gjithashtu, universiteti ka zyrën e karrierës dhe të studentëve të diplomuar, e cila ndihmon në këtë drejtim.</p> <p>[Ref. Vendim i Departamentit të Teologjisë “Ndërto Karrierën tënde” 29.05.2019].</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>RVJ konstaton se studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme lidhur me procesin mësimor nëpërmjet e-mailit dhe web faqes, lidhur me orarin e mësimit, orarin e provimeve, vendin e zhvillimit të tyre dhe konsultimeve. Gjithashtu nëpërmjet platformës e-learning, lektori mund të zhvillojë një strukturë të veçantë që i ofron të gjitha informacionet e këtij lloji.</p> <p>[Ref. http://www.kulogos.edu.al/logos-online.html].</p>
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>RVJ në bazë të të dhënave nga RVB dhe vizitave në institucion, konstaton se informacioni lidhur me programin e studimit jepet nga sistemet (EDU Page dhe TEAMS) për mbledhjen, përpunimin dhe transmetimin e të dhënave, që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike, që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Studentët regjistrohen në sistem dhe që nga dita e parë e studimeve të tyre marrin nga platforma informacionin, që lidhet me studimet e tyre.</p>

	[Ref. Students-Guide NEO-LMS].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	GVJ gjatë vizitës në institucion, si dhe nga takimet me drejtues të njësive bazë dhe me sekretarinë, konstaton se Kolegji Universitar “Logos”, disponon të dhëna statistikore të cilat përpilohen në përfundim të çdo viti akademik dhe i përcillen edhe MASR. Këto të dhëna ruhen elektronikisht dhe në hard copy në zyrën e sekretarisë mësimore. Në këto të dhëna pasqyrohet numri i studentëve, që kanë hyrë në vitin akademik, numri i studentëve, që kanë kaluar vitin dhe numri i studentëve të diplomuar. Për Programin Bachelor në “Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze”, brezi i parë i studentëve që do të diplomohen është brezi që ka përfunduar vitin akademik 2020-2021. [Ref. përfundime+diplomime].
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	RVJ konstatoi se në fillim të çdo viti akademik, sekretaria mësimore përgatit listat e studentëve, për programin bachelor në “Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze”, ku shënohen studentët e regjistruar në vitin e parë, studentët që transferojnë studimet, si dhe studentët që kalojnë në vitin e dytë dhe të tretë. Sekretaria mësimore, bazuar në rregulloren e institucionit, si dhe në Udhëzimin e MASR mban të dhënat e Regjistrimit Themeltar në format elektronik dhe të shkruar me dorë, konstatuar këto dhe gjatë vizitës në IAL. Në këto regjistra pasqyrohen gjithashtu edhe largimet/çregjistrimet përpara përfundimit të studimeve. Këto statistika i komunikohen edhe departamentit përgjegjës për këtë program studimi për nevojat e vetë-vlerësimit për raportin vjetor dhe hartimit të planit vjetor me objektivat e tij. [Ref. Rregullorë e përgjithshme e KU “Logos”; Regjistra themeltarë; Ngarkesa totale e personelit akademik të programit].
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre.	Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit, që nga pranimit (mesataren në hyrje), deri në diplomimin e tyre dhe rezulton se i analizon ato në analizat vjetore. Sekretaria mësimore, arkivon procesverbalet e provimeve në përfundim të çdo sesioni provimesh dhe pasqyron vlerësimet e studentëve në regjistrin e arritjeve akademike. Vlerësimet e studentëve gjenden edhe në platformën e EduPage dhe në këtë mënyrë ato janë të aksesueshme nga studentët, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

	[Ref. Regjistër i arritjeve akademike; Gjenerimi i notave nga Edu page].			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga Sekretaria Mësimore, janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, si dhe gjithashtu janë të aksesueshme nëpërmjet Portalit të Studentit.</p> <p>Sekretaria Mësimore gjithashtu disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalëse.</p> <p>Nuk ka analiza të punësimit të studentëve për faktin se ky është viti i parë i daljes së tyre në tregun e punës. etj.</p> <p>[Ref. Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Raporti Vjetor 2018-2019, 2019-2020].</p>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>GVJ konstaton se Departamenti ka krijuar një bazë të dhënash në të cilën fut të gjithë informacionin e nevojshëm për secilin student në mënyrë që të ndërtojë profilin e tij/saj akademik dhe profesional. Të dhënat për secilin student janë të sigurta dhe të disponueshme për studentët për t'i ndihmuar ata të kuptojnë progresin e tyre dhe qëllimet që duhet të vendosin para diplomimit.</p> <p>Nuk ka analiza të punësimit të studentëve sepse ky është brezi i parë i të diplomuarve në këtë program.</p> <p>[Ref. Raport periodik analitik i Departamentit 2021].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>GVJ konstaton se KU “Logos” inkurajon studentët të jenë pjesë aktive e organizimit dhe menaxhimit brenda institucionit. Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale brenda institucionit, siç janë: Senati akademik; Komisionii i përhershëm i garantimit të cilësisë në Arsimin e Lartë; Komisioni i përhershëm i marrëdhënieve me studentët; Këshilli i Etikës; ndërsa përfaqësuesi i studentëve në Senatin Akademik të KU “Logos” rezulton se është student i Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës.</p> <p>Përfaqësuesit e studentëve përfshihen gjithashtu në vendimmarrje dhe sugjerimet e tyre diskutohen në mbledhjet e departamentit. Departamenti ndjek rregulloret dhe statutet e institucionit për këshillin studentor dhe u ka dhënë studentëve të drejtën të formojnë organin e tyre në mënyrë që të marrin iniciativë për përmirësimin e studimeve të tyre, për promovimin e teologjisë dhe për aktivitetet sociale. Studentët kanë dhënë mendimin e tyre zyrtar mbi rregulloret e Departamentit dhe kanë punuar bashkë me personelin akademik në komisione për përmirësimin e Departamentit.</p>

	<p>Këto parashikime reflektohen edhe te dokumente rregulluese, që lidhen më ngushtë me programin e studimit nën vlerësim, siç është Rregullorja e Fakultetit. Studentët e programit të studimit marrin pjesë po ashtu edhe në hartimin e kalendarit të provimeve të tyre.</p> <p>[Ref. Statuti i Këshillit Studentor; Rregullore e Këshillit Studentor; Rregullore e përgjithshme e KU Logos; Vendim Departamenti; Raport mbi Hartimin e Rregullores së Departamentit të Teologjise dhe Kulturës; Korrespondenca me studentët për programin e provimeve].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Bazuar në RVB, KU “Logos” mbështet organizmat studentorë të krijuar nga zgjedhjet e organizuara nga vetë studentët, të monitoruar dhe mbështetur nga Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Këshillit Studentor.</p> <p>Një shembull konkret rezultoi miratimi i kërkesës së disa studentëve të Departamentit të Teologjisë gjatë kohës së pandemisë, për mundësimin e pagesës së internetit, apo huazim kompjuterash nga institucioni, për të mundësuar mësimin online. Veprimtari të tjera, të cilat iniciohen nga studentët për veprimtari të propozuara nga këshillat, janë dhe blerje librash, kompjuteri e laptopë.</p> <p>[Ref. Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor; Financimi i veprimtarive nga Këshilli Studentor; Realizimi Buxhetit 2018-2019-2020; Korrespondenca e studentëve mbi Rregulloren e Departamentit].</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstaton se, gjatë përmirësimit të programit të studimit, janë marrë në konsideratë ngarkesa e studentëve dhe janë lehtësuar disa nga ngarkesat në kurikulum. GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se institucioni synon që procedurat e transferimit, të respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore (Rregulloren dhe Statutin e KU “Logos”).</p> <p>Por megjë programi është specifik në “Teologji” nuk ka transferime nga degë të tjera në këtë program.</p> <p>[Ref. Vendim departamenti për mentorin akademik; Ngarkesa sipas formave të mësimdhënies].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>RVJ konstaton se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. Kështu IAL zhvillon takime të shpeshta midis studentëve dhe lektorëve me qëllim që të diskutohen problemet dhe çështjet me të cilat ata përballen gjatë semestrit për procesin e mësimdhënies, nevojën e krijimit të aktiviteteve të reja arsimore, apo ndryshimet në programin e studimit. Për këtë zhvillohen disa pyetësorë lidhur me syllabuset, provimet, pyetësor për platformat online, të cilat zhvillohen nga departamenti dhe shërbejnë në rritjen e cilësisë së programit.</p> <p>[Ref. Zhvillimi i pyetësoreve mbi syllabuset; Mbi pyetësorët e provimeve 2020-2021; Pyetësorët; Pyetësor për platformat 2020; Pyetësor nga Departamenti; Minutat e intervistave me studentët].</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga</p>	<p>GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimit, si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre.</p> <p>Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët, mbas hedhjes së notave në sistem, studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit, që shqyrtohet nga komisioni i provimit të departamentit, i cili përpiqet të</p>

<p>ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>kuptojë objektivisht nëse ankesa e studentit është e vlefshme dhe të dëgjojë mendimin e lektorit. Pasi merr në konsideratë të dy palët, komisioni publikon më pas një vendim zyrtar mbi këtë çështje, i cili u komunikohet të dy palëve.</p> <p>Studentët gjithashtu kanë të drejtë të shprehin perceptimet e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve nëpërmjet anketimeve semestrale, që zhvillohen në institucion. [Ref. Vendim Departamentit të Teologjisë, Komisioni Mbikqyrës për Provimet 08.02.2021; Rregullorja e Departamentit të Teologjisë dhe kulturës; Vendim i Komisionit të Provimeve - Kërkesa e studentit për rishqyrtim].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet njësi ve të posaçme në strukturën organizative zhvillon procedura në shërbim të informimit të studentëve mbështetur në statutin edhe rregulloren e KU “Logos”. Përsa më sipër është Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, që në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe atë bazë informojnë studentët në mënyrë të vazhdueshme. Një rol të rëndësishëm luajnë edhe këshilltarët akademikë.</p> <p>[Ref. Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës; Rregullore e përgjithshme e KU “Logos”].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>RVJ konstaton se Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës organizon në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet një kalendari aktivitete të miratuar çdo fillimviti akademik, leksione të hapura, workshope dhe seminare informuese.</p> <p>Studentët gjithashtu mund të hyjnë me kodet e tyre për të marrë informacion nga platforma EduPage në lidhje me progresin e tyre akademik. Gjithashtu institucioni i mentorit akademik është një shërbim i pavarur i Departamentit, që bashkëpunon me sekretarinë e Departamentit për çështjet e kontrollit të progresit të studentëve. Pas regjistrimit të notave, mentori akademik fton studentët me vështirësi të caktuara arsimore, të diskutojnë dhe të hartojnë një plan akademik nëse ka nevojë për përmirësim.</p> <p>[Ref. Aktivitetet për vitet akademike; Plani Strategjik për programin-Raport 2021].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar</p>	<p>Bazuar në RVB, konstatohet se përpara fillimit të vitit akademik pasardhës, KU “Logos” organizon takime informuese me studentët e tij që përfundojnë nivelin Bachelor për t’i orientuar për mundësitë e tyre për studime pasuniversitare në nivelin Master. Këto takime realizohen me</p>

<p>informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Dekanët, Përgjegjësit e Departamenteve dhe përfaqësuesit e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës. Studentët informohen gjithashtu edhe nëpërmjet e-mailit dhe kanaleve të tjera informuese të institucionit. Krahas këtyre programi i mentorimit “Ndërto karrierën tënde” i Departamentit të Teologjisë është një ndihmesë profesionale ndaj studentëve mbi këto çështje për të ardhmen e tyre profesionale dhe akademike. Ky program ka krijuar një bazë të dhënash me karakteristikat dhe pikat e forta të secilit student dhe gjithashtu ka lejen nga studentët që merr pjesë në program për të siguruar ndihmë nga baza e të dhënave e programit mbi kërkimin e punës ose mbi mundësitë alternative akademike. [Ref. Vendim departamenti lidhur me Programin e mentorimit “Ndërto karrierën tënde”].</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës pranë KU “Logos” disponon të dhëna statistikore mbi punësimin e të diplomuarave. Kjo zyrë në bashkëpunim me Fakultetet është në komunikim të vazhdueshëm me kompanitë për integrimin e studentëve në tregun e punës që nga realizimi i praktikave deri në punësim. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike dhe private në vend për kryerjen e praktikave profesionale, të cilat në shumicën e rasteve kanë ofruar edhe punësim të mëtejshëm për studentët, përtej zhvillimit të praktikës si kualifikim i tyre profesional. KU “Logos” mban gjithashtu kontakte me subjektet, të cilat kanë punësuar studentët e tij, nëpërmjet një formulari ku merren perceptime lidhur me mënyrën se si studenti është integruar në tregun e punës, si dhe merren sugjerime të vlefshme nga ata lidhur me ndryshimet në kurrikul. Studentët po ashtu janë ftuar të bëhen pjesë e Panaireve të Punës, të cilat i japin mundësi atyre të njihen me punëdhënës potencialë. [Ref. Analiza e punësimit të studentëve të diplomuar; Marrëveshje në kuadër të Erasmus+; Marrëveshje me “Frymë Dashurie”; Marrëveshje me KOASH; Lista e partneriteteve; Pjesëmarrja në Panairin e Punës].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbyshet pjesërisht</p>	<p>Përmbyshet kryesisht</p>	<p>Përmbyshet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbyshet pjesërisht</p>	<p>Përmbyshet kryesisht</p>	<p>Përmbyshet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-------------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ referuar RVB, si dhe takimeve në institucion konstaton se KU "Logos" ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, përgjegjësitë e të cilës janë sanksionuar në statutin dhe rregulloren e IAL-së.</p> <p>Gjithashtu, Senati Akademik, në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015, ka themeluar Komisionin e Përherëshëm për Vlerësimin Institucional, i cili harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë të shprehura në Statutin e KU "Logos", përgjigjet për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe shqyrton ankesat në kuadrin e vlerësimit të brendshëm. Veprimtaria e sigurimit të cilësisë parashikohet nga Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë, Politika të Sigurimit të Cilësisë dhe instrumentet e miratuara. [Ref. Statuti; Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë].</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e cilësisë, ku përfshihen studentë, bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. KU "Logos" ndjek gjithashtu procedurën e vlerësimit periodik çdo vit, nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve në fund të çdo semestri. Edhe studentët marrin pjesë po ashtu në vlerësimin e programit të studimit dhe të procesit mësimor. [Ref. Vendime mbi përbërjen e NJSBC (2011, 2018, 2020) të Kolegjit Universitar "Logos"; Zhvillimi i pyetësorëve mbi përmirësimin e syllabuseve mbi kontrollin e regjistrave, Viti akademik 2019-2020].</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Në bazë të RVB, konstatohet se Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përdor metodologjitë e vlerësimit dhe instrumentet e matjes, për ecurinë e programit të studimit, si dhe metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta të vlerësimit sipas rregulloreve të saj dhe bashkëpunor me Departamentin dhe Fakultetin e Shkencave Humane. Institucioni i Sigurimit të Cilësisë ka ngritur strukturat përkatëse, të cilat merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të përshtatshme për sigurimin e cilësisë dhe Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet nëpërmjet procesit të vlerësimit dhe akreditimit të jashtëm. [Ref. Rregullore e Sigurimit të Cilësisë].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>RVJ konstaton se institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedurat periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Departamenti, në raportet periodike, i referohet progresit dhe qëllimeve për t'u arritur sipas të dhënave, që ai merr nga raportet periodike të zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të institucionit. [Ref. Politika për sigurimin e cilësisë; Raport nga NJSBC për rezultatet].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	GVJ referuar strukturës organizative dhe takimeve në institucion, konstaton se Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë monitoron, rishikon dhe kontrollon ecurinë e programit të studimit të ciklit të parë. Pjesë e këtij procesi janë pyetësorët e realizuar nga njësia për stafin akademik dhe studentët, ku rezultatet e këtij procesi dhe raporti i komunikohet autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit, të cilët i marrin ato në konsideratë. Gjithashtu institucioni rezulton se për identifikimin e nevojës për rishikimin e kurrikulave ka ngritur një grup pune së bashku me udhëzimet mbi procedurën dhe praktikën e mira në këtë drejtim. Ndryshimet rezultojnë se janë kryer në një masë më pak se 20% dhe më pas janë raportuar në Ministrinë e Arsimit, sipas parashikimeve ligjore. [Ref. Paketa e Instrumenteve të NJSBC; Raport nga NJSBC për rezultatet; Procedura për ndryshimin e kurrikulës deri në masën 20 %; Zhvillimi i pyetësorëve mbi syllabuset].
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	NJSBC-ja, si njësi integrale e KU "Logos", ka krijuar një mekanizëm zyrtar dhe publikon çdo vit raporte mbi rezultatet e procesit të vlerësimit të programit të studimit. Disa nga proceset dhe mekanizmat periodike për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit Bachelor në "Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze" paraqiten në procesverbalet e mbledhjeve të departamentit të Dekanatit dhe të Asamblesë së Fakultetit. [Ref. Raport nga NJSBC për rezultatet; Zhvillimi i pyetësorëve mbi përmirësimin e syllabuse mbi kontrollin e regjistrave, Viti akademik 2019-2020; Mbledhja e Fakultetit të Skencave Humane].
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përdor metodologjitë e vlerësimit dhe instrumentet e matjes, për ecurinë e programit të studimit, si dhe metodat indirekte dhe të drejtpërdrejta të vlerësimit sipas rregulloreve të kësaj zyre. Nga shqyrtimi i Raporteve Vjetore dhe të Vlerësimit të Brendshëm në rang institucional dhe në rang departamenti, shihet se institucioni përdor instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve, ku rezultatet e anketimit të studentëve për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve të tyre shqyrtohen dhe u raportohen me sugjerime njësive përgjegjëse. Pjesë e këtij procesi janë pyetësorët e realizuar nga NJSBC për stafin akademik, të cilat shërbejnë për mbledhjen e opinionit të tyre lidhur me institucionin dhe rritjen e cilësisë së programit të studimit, pyetësorë lidhur me syllabuset, pyetësorë për provimet, vlerësime të kryera nga NJSBC, si dhe pyetësorë për vlerësim nga departamenti. Njësia zhvillon gjithashtu edhe takime periodike me studentët dhe stafin akademik.

	[Ref. Rregullore e Sigurimit të Cilësisë; Zhvillim pyetësore mbi syllabuset; Mbi pyetësorët e provimeve; Vlerësime të kryera nga NJSBC; Pyetësorët e vlerësimit nga Departamenti].			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	RVJ, bazuar në raportin e NJSBC, konstaton se në pyetësorët e studentëve, vërehet se ata shprehin mendimin për të qenë pjesë më aktive në përmirësimin e programit të studimit, si dhe dhënien e mendimit për literaturën e përdorur për lëndë të ndryshme. Studentët gjithashtu kanë shprehur mendimin se përgatitja e leksioneve dhe përzgjedhja e literaturës, duhet të përmirësohen në shërbim të mësimnxënies. Lidhur me këto rekomandime të studentëve, RVJ nuk konstatoi një plan masash nga njësia bazë. <i>GVJ rekomandon njësinë të hartojë një plan masash lidhur me rekomandimet e studentëve.</i> [Ref. Raport nga NJSBC për rezultatet; Internal Quality Assurance Unit Reports].			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	GVJ konstaton se bazuar në raport dhe evidencat e pyetësorëve, raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, por nuk hasi në ndonjë raport plan masash të lëna për rekomandimet e dhënë nga studentët, të cilat shërbejnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. <i>Ashtu si në kriterin e mësipërm, GVJ rekomandon njësinë të hartojë një plan masash lidhur me rekomandimet e studentëve.</i> [Ref. Raport nga NJSBC për rezultatet; Internal Quality Assurance Unit Reports].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	GVJ konstaton se NJSBC-ja kryen vlerësime të brendshme të programit të studimit në mënyrë periodike, i cili është i përfshirë në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit, apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike, monitoron rregullisht realizimin e programit të studimit dhe rezultatet e studentëve të arritura në procesin mësimor, analizon rezultatet mesatare për semestër, ndjek nga afër studentin gjatë praktikës profesionale, si dhe gjatë përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës. Të gjitha këto të dhëna përfshihen në raportin vjetor të Departamentit. [Ref. Raporti Vjetor 2018-2019, 2019-2020].
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me	Bazuar në RVB konstatohet se Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përdor metodologjitë e vlerësimit nëpërmjet instrumenteve të matjes, siç janë dhe pyetësorët. Mënyra dhe procesi i vlerësimit janë

<p>natyrën dhe specifikhën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>paraqitur në rregulloret e kësaj zyre. Për kryerjen e vlerësimit, grupet e punës përdorin metoda e instrumente të ndryshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti Vjetor i Kolegjit Universitar “Logos”; - Të dhënat nga instrumentet matës për performancën e pedagogut dhe cilësisë së mësimdhënies; - Raportet vjetore; - Strategjia për Zhvillimin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. - Intervista gjysëm të strukturuar dhe sondazhe me aktorët e interesit. - Intervista gjysëm të strukturuar dhe sondazhe me studentë. <p>[Ref. Rregulloret e Sigurimit të Cilësisë; Paketa e Instrumenteve të NJSBC; Raport nga NJSBC për rezultatet; Raporti Vjetor 2018-2019, 2019-2020; Propozim për një trajnim për zhvillimin e Fakultetit].</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Referuar RVB, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, institucioni kryen vlerësime të drejtpërdrejta për të cilat bazohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Treguesit e përcaktuar në Planin Strategjik të Zhvillimit të KU “Logos”, në Planin Strategjik të Kërkimit Shkencor dhe në Raportin vjetor të KU “Logos”; - Vlerësimet e drejtuesve; ekspertëve; kolegëve; studentëve; diplomuarve; bashkëpunëtorëve; punëdhënësve; - Të dhëna nga anketimet, plotësimet e formularëve të vlerësimit, intervistave, vëzhgimeve, rezultateve të provimeve të diplomimit. <p>Gjatë kushteve të pandemisë, Departamenti ka vazhduar kryerjen e vlerësimeve të pedagogëve nga studentët (përmes anketimit), duke kaluar nga vlerësime në letër në vlerësimin online.</p> <p>[Ref. Plan: Strategjik i zhvillimit të KU “Logos” 2018-2024; Raporti vjetor i kërkimit shkencor 2019-2020; Raporti vjetor 2019-2020;; Rregulloret e Sigurimit të Cilësisë; Grupet e Vlerësimit nga kolegët, Semesti i Vjeshtës].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>RVJ bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm konstaton se institucioni përdor metoda indirekte të vlerësimit. Kështu Departamenti i Teologjisë ka ngritur një strukturë të vlerësimit me anë të formularëve/pyetësorë nëpërmjet të cilëve mbledh vlerësime për cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin e didaktikës, kurrikulës, formave të të mësuarit, vlerësime të provimeve, apo detyrave të studentëve etj. Rezultatet e këtyre vlerësimeve shërbejnë për mbarëvajtjen dhe rritjen e cilësisë së programit të studimeve.</p> <p>Duke mos patur të diplomuar në këtë program studimi institucioni e ka patur të pamundur të grumbullojë të dhëna nga intervista me punëdhënës dhe të diplomuar.</p> <p>[Ref. Vendim departamenti për vlerësimin e brendshëm; Vendim departamenti për Vetëvlerësimin e Departamentit; vendim departamenti për Vlerësimin e Vazhdueshëm të Brendshëm të Departamentit-Sezoni i dimrit 2020-2021].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë, Politika e Sigurimit të Cilësisë dhe instrumentet e miratuara, së bashku me parashikimet në Statutin e institucionit, Rregulloren e tij, Rregulloren e Fakultetit dhe të programit të studimit, institucioni siguron dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Departamenti ndjek gjithashtu procedurën dhe matjet e veta, të cilat i shtohen zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. [Ref. Rregullore e Sigurimit të Cilësisë; Statuti].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin e këtyre detyrave. Departamenti gjithashtu ngre komisione gjithëpërfshirëse për vlerësimin e tij, ku përcakton detyra dhe përgjegjësi për çdo anëtar. Kështu bazuar në vendimet mbi përbërjen e NJSBC ndër vite, rezultojnë se vitet e fundit ka një pasurim të anëtarësisë së njësisë në krahasim me vitin e parë 2011, ku krahas kryetarit dhe anëtarëve, gjenden një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga studentët. Në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, neni 11, përcaktohen qartë përgjegjësitë e Komisionit të Cilësisë. [Ref. Vendime mbi përbërjen e NJSBC (2011, 2018, 2020) të KU "Logos"; Rregullore e Sigurimit të Cilësisë].</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>RVJ konstaton se në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin e studimit, e anëtarëve të personelit akademik, e asistentëve akademikë dhe administrativë dhe e studentëve të programit të studimit. Vendimet zyrtare afishohen me pjesëmarrjen e të gjitha palëve në përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe të politikës së vlerësimit të brendshëm të Departamentit për programin e studimit. Kështu, ka një komision për raportin e vlerësimit të brendshëm, i cili përbëhet nga personel akademik, personel administrativ dhe studentë. [Ref. Vendim i Departamentit të Teologjisë, Komisioni i Raportit për ASCAL].</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në RVB, Departamenti ka qenë i hapur në procesin e vlerësimit të brendshëm, duke përfutur nga mendimet e studentëve, si dhe personelit akademik dhe atij administrativ. Në pyetësorët e studentëve respektohet anonimat dhe çdo anëtar i stafit ka të drejtë të shprehë publikisht mendimin e vet për çështje, që kanë të bëjnë me ecurinë e programit të studimit, si në raportet e tyre, ashtu edhe në mbledhjet e Departamentit, të cilat janë organi kryesor i vendimmarrjes dhe përgatitjes së politikave.</p>

	[Ref. Vendim departamenti për Vlerësimin e Brendshëm; Vlerësime të kryera nga Departamenti; Pyetësorët; Pyetësorët e syllabuseve; Pyetësorët e vetëvlerësimit; Pyetësorët e provimeve 2020-2021; Pyetësor për platformat 2020-pedagog; Pyetësor nga Departamenti].			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bazuar në RVB, rezulton se Departamenti vlerëson mendimin e kontribuuesve të jashtëm. Kështu referuar dhe evidencave, në përbërje të NJSBC-së ka dhe një ekspert të jashtëm. Ndërkohë bazuar dhe në vizitat dhe intervistat në institucion vihet re se departamenti dhe kurrikulat e këtij programi studimi kanë përfituar gjithashtu dhe nga stafi akademik i universiteteve të huaja, të cilët referuar dhe dosjeve të tyre në Zyrën e Burimeve Njerëzore rezultojnë se janë ekspertë të fushës së teologjisë. Nuk ka ndonjë të dhënë se si përthithet mendimi i bashkëpunëtorëve të huaj dhe si zbatohet ai. <i>GVJ sugjeron të përfshihen në raport edhe vlerësimet, mendimet dhe sugjerimet e ekspertëve të jashtëm, si një zë i rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së programit, duke qenë se ky program është i ri në IAL dhe në vendin tonë.</i> [Ref. Vendime mbi përbërjen e NJSBC (2011, 2018, 2020); Raporti vjetor; Cilësia e stafit mësimdhënës; Të dhënat për kualifikimin e stafit dhe raportet; minutat e intervistës].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni bën publike në mënyre transparente politikat, strategjitë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Raporti vjetor i Departamentit në shqip dhe anglisht, si dhe raportet e vlerësimit të brendshëm publikohen gjithashtu në faqet e internetit: https://theolkulogosalb.wordpress.com https://theolkulogos.wordpress.com</p> <p>Bazuar në RVB dhe evidenca RVJ konstaton se institucioni i bën transparente për të gjithë dhe publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. GVJ konsultoi gjithashtu dy raporte, të vitit 2018-2019 dhe të vitit 2019-2020. <i>GVJ rekomandon që institucioni të hartojë një plan program më të detajuar, ku adresohen përmirësimet e sugjerimeve.</i></p> <p>GVJ konstaton se raportet u referohen kryesisht pikave të forta të programit dhe të departamentit. Ato përmbajnë sugjerime për aspektet që Departamenti mund të përmirësojë. Bazuar në raportet periodike analitike të Departamentit për vitin 2019 dhe 2020 mund të marrim si shembull një prej sugjerimeve, siç është rinovimi i laboratorit</p>

	<p>kompjuterik, i cili bazuar në raportin analitik të vitit 2021 rezulton se është rinovuar. Megjithatë, siç e kemi theksuar edhe më sipër mungon një plan masash i detajuar lidhur me zgjidhjen edhe të problematikave të tjera të dala nga pyetësorët.</p> <p>[Ref. Plani Strategjik i zhvillimit të KU “Logos”, 2018-2024; Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale; Raport periodik analitik i Departamentit 2019, 2020, 2021].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, institucioni dhe Departamenti përsërisin çdo vit dhe çdo semestër, procesin e vlerësimit në mënyrë që të monitorojnë progresin, ndryshimet dhe efektivitetin e shërbimeve të reja që Departamenti ka nisur. Fokusi kryesor është monitorimi i procesit mësimor, cilësia e programit të studimit dhe ndryshimi në jetën akademike i aktiviteteve jashtëkurrikulare.</p> <p>[Ref. Raport periodik analitik i Departamentit 2019, 2020, 2021; Minutat e intervistës].</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>RVJ gjatë vizitës në institucion, si dhe bazuar në intervistat me stafin dhe studentët, konstaton se Departamenti u shpjegon studentëve dhe personelit akademik rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe të akreditimit të programeve të studimit në fillim të çdo viti akademik, gjatë javëve të orientimit. Diskutime të ngjashme zhvillohen edhe në fund të çdo semestri, e cila është faza e parë e procesit të vlerësimit. Ndërsa më pas organizohen disa pyetësorë qoftë në lidhje me syllabuset, provimet, etj., të cilat nxjerrin në pah problematikat për të cilat nevojiten përmirësime afatgjatë për cilësinë e programit të studimit.</p> <p>[Ref. Zhvillimi i pyetësoreve mbi syllabuset; Mbi pyetësorët e provimeve 2020-2021; Pyetësorët; Pyetësor për platformat 2020; Pyetësor nga Departamenti].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Logos”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i Studimit i Ciklit të Parë Bachelor në “Teologji Sociale dhe Shkencat Religjioze”, ofrohet si një program unik në fushën e studimeve të teologjisë, asaj ortodokse në veçanti, ndaj përbën risi në ofertën akademike shqiptare, që i shërben ruajtjes dhe promovimit të interesave dhe vlerave kombëtare.
2. Institucioni ka bërë pjesë të stafit mësimdhënës edhe personel akademik të profilit të programit me kontratë nga universitete jashtë vendit, me përvojë, grada shkencore e tituj akademikë, që kanë forcuar cilësinë e mësimdhënies e atë kërkimore -shkencore në sajë të ekspertizës së tyre.
3. Departamenti ka një infrastrukturë efektive në një kampus të veçantë, si atelie për pedagogjinë, laborator të gjuhës së huaj, laboratorë të informatikës, si dhe dy biblioteka të pasura me literaturën e nevojshme. Kampusi ofron gjithashtu mjedise të posaçme për realizimin edhe të praktikave profesionale gjatë viteve të studimit.

Pika të dobta:

1. Promovimi i pamjaftueshëm i programit për publikun e interesuar, nisur si nga rëndësia dhe aktualiteti i tij, por edhe nga vetë synimet mbi të cilat është hartuar programi, për të krijuar gërshetimin me shkencat albanologjike, për përgatitje kuadrosh të specializuar për studimin, menaxhimin dhe promovimin e trashëgimisë së krishterë kulturore në Shqipëri dhe në Europë, për ekspertë që aftësohen për organizma arsimorë, sociale, kulturorë, fetare pranë institucioneve kërkimore dhe organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me qasje ndaj problematikave sociale e kontributit të komuniteteve fetare në nevojat e vendit dhe në dialogun ndërfaqor e ndërkulturor.
2. Promovimi i pamjaftueshëm i programit ka ngushtuar edhe mundësitë e aksesin e studentëve në zhvillimin e praktikës mësimore, pasi institucionet pritëse janë të kufizuara vetëm në institucionet e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.
3. Mungesa e një studimi të thelluar paraprak mbi nevojat e tregut.

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon që strukturat përkatëse të KU “Logos” të angazhohen më shumë për të gjetur format e duhura për një promovim e marketing më efikas të programit, përmbajtjes e objektivave të tij, pranë institucioneve shtetërore e private, fetare e të shoqërisë civile, duke argumentuar rëndësinë e nevojën e ekspertëve në fushën e teologjisë sociale e shkencave të religjionit, për të krijuar më shumë hapësirën e kushtet për akses punësimi pranë tyre. Të propagandohet me shumë profili, për qasje ndërdisiplinore e risi, i rëndësishëm për tregun e punës dhe dinamikat e zhvillimit kombëtar, shoqëror e kulturor.
2. GVJ rekomandon që të realizohet një studim më i thelluar mbi nevojat e tregut.
3. GVJ rekomandon që të vazhdohet të theksohet e të reflektohet edhe më shumë në syllabuset e lëndëve, në veprimtaritë kërkimore e shkencore, në aktivitetet kurrikulare dhe ekstrakurrikulare të studentëve, orientimi për një qasje ndërdisiplinore të programit e lidhja e tij me fushat e tjera të shkencave humane si dhe trajtesa e problematikave të tyre në kontekstin e aktualitetit shqiptar.

4. GVJ rekomandon se pavarësisht se departament është i ri dhe kushteve të pandemisë, njësia bazë të shohë mundësinë e organizmit të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe t'i jipet një prioritet kërkimit shkencor në nivel departamenti.
5. GVJ rekomandon që IAL të sigurojë forma alternative të gjenerimit të fondeve nga projektet e financuara nga AKSHI, projekte të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, etj.
6. GVJ sugjeron rritjen e numrit të partneriteteve dhe mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve.
7. GVJ sugjeron që webfaqja e internetit të jetë më e decentralizuar, duke krijuar mundësi edhe për kalimin në faqe interaktive të çdo njësie kryesore, për të ofruar një organizim më efektiv të informacionit për kategori specifike përdoruesish të interesuar për Departamentin e Teologjisë, siç janë psh. rubrika e stafit dhe aktivitetet e departamentit.
8. GVJ rekomandon njësinë të hartojë një plan masash lidhur me rekomandimet e dala nga pyetësorët e studentëve.
9. GVJ sugjeron të përfshihen në raportin e NJSBC-së edhe vlerësimet, mendimet dhe sugjerimet e ekspertëve të jashtëm, si një zë i rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së programit, duke qenë se ky program është i ri në IAL dhe në vendin tonë.
10. GVJ sugjeron që programi i studimit duhet të promovohet më shumë, në mënyrë që studentët të kenë hapësirat e mjaftueshme për zhvillimin e praktikës mësimore, jo vetëm në institucionet e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, por edhe në institucione të tjera.
11. GVJ sugjeron të përfshihen në raport edhe vlerësimet, mendimet dhe sugjerimet e ekspertëve të jashtëm, si një zë i rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së programit, duke qenë se ky program është i ri në IAL dhe në vendin tonë.
12. GVJ rekomandon njësinë të hartojë një plan masash lidhur me rekomandimet e studentëve.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program in "Social Theology and Religious Sciences" of the Institution of Higher Education "Logos" University College

Strengths and affirmations:

1. The first cycle study program Bachelor in "Social Theology and Religious Sciences", is offered as a unique program in the field of theological studies, the Orthodox in particular, so it is an innovation in the Albanian academic offer, which serves the preservation and promotion of national interests and values.
2. The institution has made part of the teaching staff academic staff from universities abroad, with experience, scientific degrees and academic titles, which have strengthened the quality of teaching and scientific-research thanks to their expertise.
3. The department has an effective infrastructure in a special campus, such as pedagogical studios, foreign language laboratories, computer labs, as well as two libraries rich in the necessary literature. The campus also offers special facilities for the realization of professional practices during the years of study.

Weaknesses:


1. Insufficient program promotion for the interested public, starting from its importance and topicality, but also from the very goals on which the program is designed, to create intertwining

with albanological sciences, for the preparation of specialized staff for the study, management and the promotion of Christian cultural heritage in Albania and in Europe, for experts trained in educational, social, cultural, religious organizations at research institutions and national and international organizations, with access to social issues and the contribution of religious communities to the needs of the country and in interfaith and intercultural dialogue.


2. Insufficient promotion of the program has narrowed the opportunities and access of students to the development of teaching practice, as the host institutions are limited only to the institutions of the Autocephalous Orthodox Church of Albania.
3. Lack of an in-depth preliminary study on market needs.

Recomandations:

1. EEG recommends that the relevant structures of "Logos" UC to engage more to find the right forms for a more efficient promotion and marketing of the program, its content and objectives, at state and private institutions, religious and civil society, arguing the importance and need of experts in the field of social theology and religious sciences, to create more space and conditions for employment access near them. To propagate with many profiles, for interdisciplinary approach and innovation, important for the labor market and the dynamics of national, social and cultural development.
2. EEG recommends that a more in-depth study on market needs be conducted.
3. EEG recommends to continue emphasizing and reflecting even more in the syllabi of courses, in research and scientific activities, in curricular and extracurricular activities of students, orientation for an interdisciplinary approach of the program and its connection with other areas of humanities and the treatment of their problems in the context of current Albanian.
4. EEG recommends that despite the fact that the department is new and the pandemic conditions, the basic unit should consider the possibility of organizing national and international conferences and give a priority to research at the department level.
5. EEG recommends that HEIs provide alternative forms of fundraising from projects funded by AKSHI, other national and international projects, etc.
6. EEG suggests increasing the number of partnerships and mobility of academic staff and students.
7. EEG suggests that the website be more decentralized, creating opportunities for the interactive page of each major unit to provide a more effective organization of information for specific categories of users interested in the Theology Department, such as e.g. staff section and department activities.
8. EEG recommends the unit to develop a plan of action regarding the recommendations arising from the student questionnaires.
9. EEG suggests to include in the IAU report the evaluations, opinions and suggestions of external experts, as an important voice in improving the quality of the program, as this program is new in HEIs and in our country.
10. EEG suggests that the study program should be further promoted, so that students have sufficient space for the development of teaching practice, not only in the institutions of the Autocephalous Orthodox Church of Albania, but also in other institutions.
11. EEG suggests to include in the report the evaluations, opinions and suggestions of external experts, as an important voice in improving the quality of the program, given that this program is new in HEIs and in our country.



12. EEG recommends the unit to draft a plan of measures related to students' recommendations.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X